

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5702
E enjte, 14 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

BE-ja duhet t'ia lejojë Kosovës udhëtimin pa viza

FAQE 6

Nga Behgjet PACOLLI



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", AFRIM HOTI

FAQE 4-5

KOSOVA DUHET TË REFLEKTOJË NDAJ KËRKESAVE TË SHBA-SË

- Qeveria e Kosovës ta pezullojë taksën për një periudhë të caktuar



Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka thënë se Kosova duhet të reflektojë ndaj kërkesave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA-së). Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet ta pezullojë taksën ndaj Serbisë në mënyrë që t'i

jepet mundësia procesit të dialogut dhe arritjes së marrëveshjes gjithëpërfshirëse. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoti ka vlerësuar se taksën ka pasur efekt dhe tani është koha për një reflektim të përbashkët të partnerëve të koalicionit për ta pezulluar taksën për një periudhë të caktuar duke e ruajtur interesin strategjik, që është miqësia me ShBA-në. Sipas tij, Kosova nuk ka mundur dhe nuk mund të ecë më tutje pa mbështetjen e fuqishme të ShBA-së

cionit për ta pezulluar taksën për një periudhë të caktuar duke e ruajtur interesin strategjik, që është miqësia me ShBA-në. Sipas tij, Kosova nuk ka mundur dhe nuk mund të ecë më tutje pa mbështetjen e fuqishme të ShBA-së

Shtohet presioni amerikan për heqjen e taksës

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë shtuar presionin ndaj Kosovës për heqjen e taksës për mallrat serbe. Ambasadori i ShBA-së, Philip S. Kosnett, sërish të mërkurën ka kërkuar që Kosova t'i heqë pengesat dhe të vazhdohet dialogu me Serbinë. Një ditë më parë nëpërmjet një letre zyrtarë e lartë amerikane e kanë vlerësuar të pabesueshëm faktin që Kosova po injoron këshillën e tyre për heqjen e taksës. Kryeministri Ramush Haradinaj ka përsëritur qëndrimin se nuk do ta heqë taksën, kurse ekipi negociator ua



ka dorëzuar krerëve të shtetit draft-platformën për bisedime me Serbinë

FAQE 3



I jepet lamtumira e fundit akademik Idriz Ajetit

FAQE 7

AKTUALE

PAVARËSIA E KOSOVËS NË DEKADËN E DYTË

F. 11



Salihe SALIHU - PhD kandidat

DRENASI, KOMUNA MË TRANSPARENTE

F. 5

PËR 24 ORË NË KLINIKËN EMERGJENTE, 224 RASTE

F. 11

EKONOMI

REKOMANDOHET QË MJETET E TRUSTIT TË INVESTOHEN NË KOSOVË

F. 9

PRODUKTET E KOSOVËS PREZANTOHEN NË PANAIRIN E USHQIMEVE ORGANIKE NË NUREMBERG

F. 9

KULTURË

DYLI ME VIDEOKLIPIN 'NJË MOMENT' FALËNDERON ATA QË BËNË MREKULLINË PËR TË

F. 16



SPORT

KRASNIQI: KOSOVA KA SHUMË TALENTE NË TAEKWONDO

F. 18

NË GJYSMËFINALE VËLLAZNIMI - TREPÇA '89 DHE BALLKANI - FERONIKELI

F. 18

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane - Ministry of Defense



BËHU REKRUT I FSK-së!

BËHU USHTAR I REPUBLIKËS SË KOSOVËS!

KONKURS

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës shpall konkurs për pranimin e rekrutëve të rinj – ushtarë aktivë për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Konkursi do të jetë i hapur prej datës 11 deri më 22 shkurt 2019.

Formularët për aplikim janë në dispozicion në të gjitha kazernat e FSK-së, si dhe në ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes, www.mksf-rks.org, apo www.rks-gov.net/mfsk.

Ministria e Mbrojtjes ju shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet e të rinjve pa dallim nga përkatësia e tyre etnike, gjinore dhe racore.



Dokumentet duhet të dorëzohen personalisht në të gjitha kazernat e FSK-së,
çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim.
Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr.tel. 038-603-199, 038-603-355.

Dhjetë të vdekur në aksidentin e rëndë në rrugën Shkup - Tetovë

SHKUP, 13 SHKURT - Dhjetë persona kanë vdekur si pasojë e aksidentit në autostradën Shkup - Tetovë, ndonëse bilanci mund të jetë edhe më i madh. Personat e lënduar janë transportuar në Qendrën Klinike në Shkup dhe në Spitalin "8 shtatori" në Shkup.

Patrullat policore kanë bllokuar dhe siguruar perimetrin e aksidentit. Zëvendësministri i Brendshëm, Agim Nuhiu, si dhe ministri i Shëndetësisë, Venko

Filipçe, kanë shkuar në vendin e ngjarjes, njofton "AlsatM". "Momentalisht jemi duke koordinuar aktivitetet. Ekipe të policisë dhe ato të shëndetit publik kanë qenë të koordinuar, përfshirë edhe zjarrfikësit. Për fat të keq, janë tetë viktima", deklaroi Agim Nuhiu, zëvendësministri i Brendshëm.

Kalimtarët e rastit dhe qytetarët të cilët ishin në vendngjarje kanë bërë përpjekje ta rrokullisin autobusin për të

mundësuar tërheqjen e udhëtarëve që kanë ngelur brenda autobusit. Po ashtu, mjete të rënda janë sjellë në vendngjarje për të mundësuar që ta lëvizin autobusin. Autobusi është rrokullisur në kilometrin e shtatë të autostradës Shkup - Tetovë, pas pikë pagesës së parë. Sipas dëshmitarëve, thuhet se shkak i aksidentit ishte plasja e gomës, me ç'rast autobusi ka përfunduar në korsinë e kundërt të autostradës.



Emri Maqedonia e Veriut hyn në fuqi

Shkup, 13 shkurt - Emri i ri, Republika e Maqedonisë së Veriut, ka hyrë në fuqi me publikimin e ndryshimeve kushtetuese në Gazetën Zyrtare. Paraprakisht Greqia, nëpërmjet një shkrese, ka njoftuar Shkupin me vendimin e Parlamentit grek për miratimin e protokollit për anëtarësimin e fqinjët verior në Aleancën Veriatlantike. Autoritetet maqedonase kanë bërë me dije se të mërkurën në vendkalimin kufitar me Greqinë do të vendoset tabela e parë me mbishkrimin "Republika e Maqedonisë së Veriut".

Qeveria në faqen e internetit ka ndryshuar të dhënat duke

nisur për herë të parë me përdorimin e emrit të ri, Maqedonia e Veriut. Edhe shumë zyrtarë të dhënat e institucioneve në faqet e internetit i kanë zëvendësuar me emrin e ri.

Kryeministri Zoran Zaev, pas mbledhjes së kryesisë së partisë së tij socialdemokrate, të martën në mbrëmje kërkoi nga të gjitha institucionet që t'i ndryshojnë mbishkrimet, kurse Ministria e Punëve të Brendshme ta nisë edhe ndërrimin e dokumenteve të udhëtimt dhe targat e veturave. Sipas një vendimi të Qeverisë, nga fillimi i vitit 2020 do të hidhen në qarkullim edhe



bankënotat e para me emrin e ri. Procesi i zëvendësimit të tyre do të zgjasë deri në pesë vjet, sikurse edhe ai i dokumenteve personale të qyte-

tarëve. Marrëveshja në mes të Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut për zgjidhjen e kontestit ishte arritur më 17 qershor 2018. Të dyja

vendet kanë kaluar një periudhë të gjatë dhe përplot me tensione deri në ratifikimin e marrëveshjes nga parlamentet e tyre.

Greqia kishte bllokuar për 27 vjet përpjekjet e Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në NATO dhe në Bashkimin Evropian për shkak të pohimeve se fqinji i saj ka pretendime territoriale ndaj rajonit të saj verior që mban emrin Maqedoni.

Pas miratimit të protokollit për anëtarësim në NATO, Maqedonia e Veriut në qershor pret hapjen e negociatave me Brukselin për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Maqedonia për herë të parë me ulëse në tryezën e NATO-s

BRUKSEL, 13 SHKURT - Ministria e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska, të mërkurën dhe të enjten do ta përfaqësojë Maqedoninë në mbledhjen ministrore të Aleancës, për herë të parë si anëtare e sigurt e ardhshme e NATO-s. Kjo është mbledhja e parë e anëtareve të NATO-s në vitin 2019 dhe mbledhja e parë në të cilën Maqedonia do të ulet krah për krah me aleatet e saj të Aleancës, pasi që u nënshkrua protokollit për anëtarësim javën e kaluar. "Për herë të parë do t'i



dëshirojmë mirëseardhje Shkupit, ministres së Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska, tani nga

Maqedonia e Veriut që ka ulëse në tryezën tonë", deklaroi Jens Stoltenbergu në konferencën për

shtyp në Bruksel në të cilën e paralajmëroi agjendën për këto dy ditë.

Anëtarët e NATO-s sot (e enjte) zyrtarisht do t'i dëshirojnë mirëseardhje ministres Shekerinska, e cila rreth orës njëmbëdhjetë do të pritët nga ana e Stoltenbergut, disa orë para fillimit të sesionit të parë të Këshillit Atlantik të Veriut.

Ministria planifikon disa takime dypalëshe me kolegët e NATO-s për mbrojtje gjatë vizitës së saj. Mes tyre janë takimet me minis-

trat e Belgjikës, Britanisë së Madhe, Kanadasë, Turqisë, Greqisë dhe të shteteve të tjera.

"Me pjesëmarrje të ministres Shekerinska në mbledhjen e Këshillit Atlantik të Veriut, bëhemi pjesë aktive e Aleancës, ndërsa pas procesit të ratifikimit të plotë të protokollit inkuadruar, i cili tashmë përfundoi në Parlamentin grek dhe sloven, edhe zyrtarisht do të kemi të drejtë vote në të gjitha mbledhjet e NATO-s", paralajmëruan nga kabineti i ministres së Mbrojtjes.

Basha: Hajdutët duhet të shkojnë në burg

TRANË, 13 SHKURT - Kur kanë mbebur edhe dy ditë nga protesta e 16 shkurtit, kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka zbardhur të mërkurën në Burrel. Ai ftoi të gjithë qytetarët e Burrelit që të bashkohen në protestën masive, e cila, sipas Bashës, synon ta largojë një orë dhe më parë pushtetin e të korruptuarve. Lideri demokrat në takim me

qytetarët u shpreh se problemi kryesor është vjedhja e taksave dhe bashkëpunimi i pushtetit me oligarkët. "Taksat e larta, çmimi i lartë i energjisë dhe inaftës nuk janë thjesht rritje, por kjo është vjedhje. Këta janë kapur duke vjedhur studentët, janë kapur duke vjedhur edhe votat dhe këtë e tregoi 'Zëri i Amerikës'. Sot shqiptarët e kanë parë se këta

kanë dalë lakuriq, sepse u kapën duke vjedhur.

Ju ftoj të gjithëve që, më 16 shkurt, nga gardhi matanë policëve është hajduti, ndërsa pjesa këtej është pala e vjedhur, na ndihmoni të hapim atë derë. Të bashkohemi të gjithë për Shqipërinë si gjithë Evropa. Hajdutët duhet të shkojnë në burg. Ky është thelbi i ditës së shtunë", tha Basha.



Ekipi shtetëror për dialog i Kosovës ua ka dorëzuar krerëve të shtetit draft-platformën për bisedime me Serbinë

Shtohet presioni amerikan për heqjen e taksës

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë shtuar presionin ndaj Kosovës për heqjen e taksës për mallrat serbe. Ambasadori i ShBA-së, Philip S. Kosnett, sërish të mërkurën ka kërkuar që Kosova t'i heqë pengesat dhe të vazhdohet dialogu me Serbinë. Një ditë më parë përmes një letre zyrtarë e lartë amerikane e kanë vlerësuar të pabesueshëm faktin që Kosova po injoron këshillën e tyre për heqjen e taksës. Kryeministri Ramush Haradinaj ka përsëritur qëndrimin se nuk do ta heqë taksën, kurse ekipi negociator ua ka dorëzuar krerëve të shtetit draft-platformën për bisedimet me Serbinë



anulojmë vizitën e planifikuar të gjeneralit Orr nga Garda Kombëtare e Iowas në Kosovë. Vizita e tij kishte për qëllim të

përqendrohej në bashkëpunim bilateral në fushën e sigurisë", është thënë në letër, duke shtuar se do të shikohen me kujdes aspektet e tjera të bashkëpunimit dhe do të shqyrtohet nëse edhe ato do të pakësohen/shkurtohen. "Kosova nuk ka mik më të mirë sesa Shtetet e Bashkuara. Ne kemi punuar për caq shumë vite për të realizuar një të ardhme për popullin e Kosovës në mënyrë që ai të jetojë ashtu siç ka zgjedhur, në paqe. Lufta e Kosovës për liri ka mbetur në mendjen e amerikanëve. Mijëra diplomatë amerikanë dhe ushtarë janë përfshirë personalisht në përpjekjet për të ndërtuar një të ardhme për Kosovën. Është e pabesueshme që pas gjithë çfarë kemi bërë bashkë, Kosova e vlerëson miqësinë tonë aq ulët sa t'i injorojë këshillat tona", është thënë në këtë letër. Pavarësisht prej këtyre kërkesave të ShBA-së, kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se taksa nuk do të hiqet.

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 13 SHKURT - Këmbëngulja e Qeverisë së Kosovës për të mos e hequr taksën për produktet serbe ka bërë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) ta shtojnë presionin ndaj Kosovës. Ambasadori i ShBA-së, Philip S. Kosnett, sërish të mërkurën ka kërkuar që Kosova t'i largojë pengesat dhe të vazhdohet dialogu me Serbinë.

Në një takim që ka zhvilluar me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, diplomati amerikan është pajtuar me shefin e shtetit që vitale është të hiqen të gjitha pengesat për vazhdimin e dialogut me Serbinë dhe t'i hapet rrugë marrëveshjes paqësore. "Kosova dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndajnë vlera, parime dhe synime të përbashkëta. Në këtë rast, synimi ynë i përbashkët është të ndërtojmë paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm në Kosovë dhe në rajon, si parakusht për zhvillim dhe prosperitet të vendit tonë. Çelës për paqen është arritja e një marrëveshjeje paqësore, gjithëpërfshirëse dhe përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë presidenti Thaçi.

Sipas tij, partneriteti i Kosovës me ShBA-në është jetësor. "Partneriteti dhe miqësia me Shtetet e Bashkuara të Amerikës është jetësor për Kosovën. Kosova ka arritur caq larg falë përkrahjes së gjithanshme të Shteteve të Bashkuara", ka theksuar presidenti Thaçi.

Një ditë më parë përfaqësuesit e lartë të Kosovës kanë pranuar një letër nga zyrtarë të lartë amerikanë, të cilët kanë shprehur zhgënjimin e tyre lidhur me mospezullimin e taksës doganore ndaj mallrave nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Në letrën të cilën e kanë nënshkruar ndihmësekretari amerikan i Shtetit, Matthew Palmer, ndihmësekretarja e Mbrojtjes, Laura Cooper dhe zëvendës drejtori për Çështje Evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare, John Earth, janë përmendur hapat që shteti amerikan ka ndërmarrë ndaj Kosovës, pas refuzimit të kërkesave të vazhdueshme të ShBA-së për pezullimin e tarifës. "Pasi që pamë që kërkesat tona për ta pezulluar taksën nuk u morën parasysh, kemi vendosur të ndërmarrim hapa që do ta shfaqin shqetësimin tonë, përfshirë këtu edhe partneritetin në fushën e sigurisë. Fillimisht, kemi vendosur ta

Ahmeti nuk e braktis Haradinajn për taksën

Një nga kryesuesit e delegacionit shtetëror për dialog, Shpend Ahmeti, ka thënë se kryeministri Ramush Haradinaj dhe as të tjerët nuk duhen lënë vetëm për çështjen e taksës ndaj mallrave serbe. Pasi ua ka dorëzuar draft-platformën për bisedimet me Serbinë krerëve të shtetit, ai ka kërkuar nga liderët institucionalë të mbajnë një qëndrim të përbashkët për këtë çështje. "Mos ta lëmë njëri-tjetrin vetë në këto tema. Nuk mund ta lëmë kryeministrin vetë. Krejt presioni tash vjen tek ai. Nuk do ta lëmë vetë njëri-tjetrin. Nëse marrim vendim bashkë me mbajt taksën, do ta mbajmë të gjithë. Nëse merret vendimi me heq taksën, ta ndajmë kritikën bashkë. Është e qartë se ka filluar të eskalojë

pak edhe marrëdhënia me ShBA-në. Megjithatë, jam i bindur se kjo nuk rrezikon marrëdhëniet tona me ShBA-në", ka thënë Ahmeti.

Ai ka bërë me dije se korrigjimi i kufijve Kosovë - Serbi nuk do të përfshihet në platformën për bisedime. "Po kërkoj të kemi një qëndrim unik si shtet. Nuk jemi të fortë karshi të tjerëve nëse kemi një përfaqësues të institucionit që thotë ky është vendim i duhur, tjetri thotë ky nuk është vendim i duhur. Kur shkojmë me një kërkesë dhe kërkesa ka qenë që Serbia të ulet pa kushte në tavolinë, nuk kemi çfarë e heqim taksën, se mund t'i qesim 100 kushte të tjera. Në momentin kur e bëjmë këtë kërkesë në Bruksel apo Uashington, ata e

dinë se ka mospajtme në Kosovë", është shprehur Ahmeti, duke treguar se platforma mund të dorëzohet në kuvend të premtën. "Pres që të premtën ta dorëzojmë zyrtarisht, pra nuk ka ndonjë befasi. Diskutua edhe një herë që t'u dorëzohet një draft edhe krerëve. Nuk pati ndonjë mospajtim. Në pjesën tjetër ishte më shumë njoftim i kryetarit të Kuvendit që dëshiroi zyrtarisht të njoftojë dhe ta marrë konfirmimin nga të gjithë nëse e kanë parë letrën e ShBA-së. Nuk mendoj se ka lëvizje të qëndrimeve sa iu përket përfaqësuesve të ndryshëm se çka mendojnë. Nuk mendoj se ka ndryshuar diçka as në qëndrimin e kryeministrit", është shprehur Ahmeti.

Shqyrtohet hapja e Zyrës Ndërlidhëse të Kosovës në Bratislavë



Prishtinë, 13 shkurt (ER) - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, ka pritur të mërkurën në një takim pune shefin e ri të Zyrës së Sllovakisë në Prishtinë, Rastislav Kostilnik. Në kuadër të këtij takimi, kryediplomati i Kosovës, Pacolli, i ka shprehur mirëseardhje udhëheqësit të ri të Zyrës sllovaqe në Kosovë, duke e uruar në detyrën e re, ndërkohë që është diskutuar mbi çështje të interesit të përbashkët në mes dy shteteve.

Vazhdimi i mbështetjes së mëtutjeshme sllovaqe në rrugëtimin e integritetit euro-atlantik dhe ndërkombëtar të shtetit të ri, si dhe nevoja për përkrahjen e Sllovakisë për liberalizimin e vizave për shtetasit e Kosovës, kanë zënë vend të veçantë gjatë diskutimeve të këtij takimi. Më pas, numri dy i Qeverisë ka uruar diplomatit sllovak në Kosovë për marrjen e Presidencës së OSBE-së, duke shprehur bindjen se udhëheqja sllovaqe do të kontribuojë edhe

më tutje për promovimin e dialogut dhe stabilitetit rajonal dhe ka kërkuar ndihmën e Sllovakisë që Kosova të jetë së paku pjesë e takimeve formale, ku flitet për rajonin dhe që marrëdhëniet Kosovë - OSBE të avancojnë gradualisht me hapa konkretë. Hapja e Zyrës Ndërlidhëse të Kosovës në Bratislavë ka qenë një kërkesë tjetër e ministrit të Jashtëm, Pacolli, për të cilën do të zhvillohen konsultimet e afërta në mes dy vendeve për gjetjen e mundësisë.

Flet për "Epokën e re", Afrim Hoti

Kosova duhet të reflektojë

- Qeveria e Kosovës ta pezullojë taksën për një periudhë të caktuar

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka thënë se Kosova duhet të reflektojë ndaj kërkesave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA-së). Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet ta pezullojë taksën ndaj Serbisë në mënyrë që t'i jepet mundësia procesit të dialogut dhe arritjes së marrëveshjes gjithëpërfshirëse. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoti ka vlerësuar se taksa ka pasur efekt dhe tani është koha për një reflektim të përbashkët të partnerëve të koalicionit për ta pezulluar taksën për një periudhë të caktuar duke e ruajtur interesin strategjik, që është miqësia me ShBA-në. Sipas tij, Kosova nuk ka mundur dhe nuk mund të ecë më tutje pa mbështetjen e fuqishme të ShBA-së



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 13 SHKURT -

"EPOKA E RE": Profesor, Shtetet e Bashkuara të Amerikës po kërkojnë pezullimin e taksës ndaj Serbisë. Edhe në letrën e fundit të saj drejtuar liderëve shtetërorë, thuhet se Amerika është e befasuar që Kosova nuk po i merr parasysh sugjerimet amerikane. Si e komentoni këtë letër dhe situatën e krijuar?

Hoti: Kemi të bëjmë me një situatë shumë serioze dhe me një ftesë po aq serioze të ShBA-së për lidhshimin politik në Kosovë. Ftesa është racionale sepse vendimi i autoriteteve të Kosovës për vendosjen e taksës ka qenë parimor dhe, pa asnjë dilemë, supozohet se ka pasur efekt dhe ka arritur objektivat. Mbi bazën e këtij rezultati është e rrugës që të reflektohet në veçanti kur kemi të bëjmë me një hurrje të ShBA-së që është partneri dhe aleati strategjik i Kosovës, në mënyrë që përmes një pezullimi t'i jepet një mundësi palës tjetër që të reflektojë në atë që njihet si marrëveshje gjithëpërfshirëse. Kjo marrëveshje nënkupton edhe plotësim të kushteve dhe të kriterëve që Kosova ka për Serbinë.

"Epoka e re": Pas sugjerimeve, kërkesave si dhe 'kërcënimeve' të Amerikës për shqyrtimin e bashkëpunimit me Kosovën në fushën e sigurisë dhe në aspekte të tjera, është momenti i fundit për reflektim të Kosovës për ta gjetur formën e duhur për

pezullimin e taksës?

Hoti: Është i logjikshëm dhe i arsyeshëm pozicioni amerikan që, nëse Kosova nuk reflekton në kërkesat e saj, atëherë është e pritshme se ShBA-ja do ta shqyrtojë pozicionin e vet në raport me Kosovën. Është detyrë e lidhshimit politik të Kosovës ta masë çështjen e interesit kombëtar nëse na duhet apo jo ShBA-ja për të ecur më tutje. Në këtë drejtim nuk ka asnjë dilemë dhe situata është shumë e qartë. Kosova nuk ka mundur dhe nuk mund të ecë më tutje pa një mbështetje të fuqishme të ShBA-së siç e kemi pasur deri tani. Prandaj Kosova duhet të reflektojë, t'i jepet mundësia procesit të dialogut dhe të ruhet me gjakftohtësi raporti dhe miqësia jonë e përhershme me ShBA-në. Kosova nuk do të mbetet pa mbështetjen e ShBA-së sepse, pavarësisht prej lidhshiveve apo klasave të caktuara politike, orientimi i qytetarëve të Kosovës është pro amerikan dhe nuk kam asnjë dilemë se kështu do të mbetet edhe në të ardhmen. Lidhshimi aktual duhet të zgjedhë nëse dëshiron ta shtyjë procesin përpara, sepse Kosova me apo pa këtë lidhshim do të mbetet amerikane.

"Epoka e re": Pozicionimi i kryeministrit Haradinaj, që taksa të mbetet në fuqi, a po i rrezikon raportet me Amerikën?

Hoti: Pozicioni dhe vendimi i kryeministrit është logjik deri më tani sepse Serbisë është dashur t'i jepet një përgjigje e tillë pas gjithë atyre veprimeve destruktive

dhe aksioneve kundër Kosovës. Taksa nuk ka qenë dhe nuk duhet të interpretohet si aksion i Kosovës, por duhet të interpretohet si reaksion i Kosovës për veprimet e Serbisë. Edhe në kuptimin e brendshëm, pra në kuptimin e zhvillimit të ekonomisë dhe të konsolidimit të shtetit, taksa ka pasur efekt, por edhe në kuptimin e jashtëm qeveria aktuale, bashkë me kryeministrin, kanë treguar vendosmëri dhe kanë mbajtur në fuqi këtë

vendim me peshë dhe përmasa kombëtare. Megjithatë, tani është çështja e balancimit dhe matjes në mes të ecjes më tutje pa amerikanët apo lëshimit për pezullimin e taksës dhe të bashkëpunimit me amerikanët si partnerët tanë strategjikë. Në kuptimin politik dhe ekonomik ka të drejtë kryeministri, kurse në kuptimin strategjik duhet të bëhet një përlogaritje dhe të shihet se cili është interesi i Kosovës. Në këtë drejtim besoj se Qeveria

e Kosovës do të reflektojë pozitivisht duke e pezulluar taksën për kohë të caktuar. Ky pezullim nuk nënkupton heqje të taksës, por dhënie mundësi palës tjetër që të reflektojë në atë që njihet si marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe në mesin e kushteve do të jetë edhe njohja e Kosovës.

"Epoka e re": Si e shihni qëndrimin jo unik të partnerëve të koalicionit për këtë çështje?

Hoti: Çështja ka qenë pak më e

ndaj kërkesave të ShBA-së

"Epoka e re": Ditë më parë kryeministri ka thënë se pranon të shkojë në shtëpi dhe nuk e heq taksën. Kjo çështje mund të çojë në rrëzimin e Qeverisë?

Hoti: Ato janë qëndrime politike të liderëve por, nisur nga vullneti qytetar, jam i bindur se taksa do të pezullohet për një kohë të caktuar.

"Epoka e re": Z. Hoti, kryeministri po insiston që vazhdimi i dialogut të mos kushtëzohet me pezullimin e taksës, nga ana tjetër presidenti është pro heqjes së taksës dhe vazhdimin të dialogut. Përveç kësaj, Thaçi dhe Haradinaj kanë qëndrime të kundërta edhe sa i përket idesë për korigjimin e kufirit me Serbinë. Si e komentoni këtë dhe, duke pasur parasysh këto qëndrime, sa ka gjasa të arrihet marrëveshja përfundimtare dhe të jetë në përputhje me interesat e Kosovës?

Hoti: E drejta e brendshme dhe e drejta ndërkombëtare sot kanë pozita krejtësisht të ndryshme njëra me tjetrën dhe në trendin aktual të zhvillimeve nuk do koment që bashkësia ndërkombëtare tani edhe në mënyrë më të dukshme ka rol, peshë, rëndësi dhe përmasa shumë më të fuqishme se në të kaluarën. Mbi këtë bazë, përtej deklaratimit të kryeministrit dhe presidentit, kemi një thirrje të komunitetit ndërkombëtar, ku pjesë përbërëse kundër vendimit për taksën është edhe ShBA-ja dhe për mua kjo është më shumë sesa indikative. Është e pakontestueshme se duhet të kemi unifikim të qëndrimeve të lidershit tonë politik dhe veprimet tona t'i bashkërendojmë me shtetet e caktuara në BE, në veçanti me ShBA-në. Amerikanët nuk janë vetëm partnerët e Kosovës, por janë bashkëpronarët e lirisë dhe të pavarësisë. Janë sponsorë dhe projektues të pavarësisë së Kosovës, prandaj është paradoksale të mendohet e lërë më të veprohet në ecjen më tutje pa amerikanët. Veprimet tona duhet t'i konsolidojmë dhe t'i bashkërendojmë me amerikanët dhe me këshillat e tyre Kosova do të ketë perspektivë dhe të ardhme të sigurt.

"Epoka e re": Jeni optimist se do të mund të arrihet marrëveshja përfundimtare dhe cila do të jetë përmbajtja e saj?

Hoti: Jam optimist se do të kemi marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe tani është e pamundur të dihet përmbajtja e saj. Mendoj se do të kemi një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe një njohje reciproke Kosovë - Serbi. Si duket kjo ka bekimin e fuqive të mëdha duke filluar nga Strategjia për zgjerim e proklamuar vitin e

kaluar nga BE-ja që u jep për detyrë Kosovës dhe Serbisë që të kenë një marrëveshje ligjrisht të obligueshme dhe bekimin amerikan që 2019-ta të jetë vit i arritjes së kësaj marrëveshje dhe zgjidhjes përfundimtare të problemit në mes të dy vendeve.

"Epoka e re": Prisni që në kuadër të kësaj marrëveshje të jetë edhe korigjimi i kufirit, siç është thënë, Lugina e Preshevës t'i bashkohet Kosovës, kurse veriu

Serbisë?

Hoti: Nuk është opsion i pamundur sepse edhe retorika, por edhe struktura juridike ndërkombëtare për momentin lejon një gjë të tillë për aq kohë sa kemi pajtueshmëri në mes të shteteve të pavarura. Nëse Kosova dhe Serbia dhe të dyja lideritet mund të merren vesh për ta ndryshuar vijën kufitare, kjo është e mundur. Një gjë e tillë lejohet edhe me mekanizmat ndërkombëtarë,

lejohet edhe nga akti final i Helsinkut i vitit 1975 që, mes të tjerash, promovon vetëm marrëveshje paqësore ose problemeve me bisedime dhe ndryshimin e kufijve vetëm me marrëveshje. Pra, mundësia ekziston, hapësira juridike e politike është e lejuar dhe e siguruar nga mekanizmat ndërkombëtarë. Varet vetëm nga reflektimi i vullnetit të lidershipeve përkatëse kombëtare.

Drenasi, komuna më transparente

PRISHTINË, 13 SHKURT (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe OJQ Aktiv në një konferencë mbajtur të mërkurën kanë bërë publikimin e raportit "Transparometri 2018", që vë në pah të gjeturat dhe rekomandimet nga matja e transparencës në 15 komuna të Kosovës. Bazuar në matjet e 58 indikatorëve në katër shtylla, komuna më transparente doli ajo e Drenasit (duke përmbushur 82.22 për qind të indikatorëve), ndërsa më pak transparente ishte ajo e Mamushës (duke përmbushur 27.12 për qind të indikatorëve).

Subjekt i këtij indeksi të transparencës ishin komunat: Drenas, Mitrovicë e Jugut, Viti, Malishevë, Klinë, Dragash, Kamenicë, Graçanicë, Obiliq, Shtërpçë, Mamushë, Mitrovicë e Veriut, Zubin

Potok, Leposaviq dhe Zveçan, ndërsa rezultatet e tyre janë si vijon: 1. Drenasi (82.22 për qind), 2. Mitrovica e Jugut (77.97 për qind), 3. Vitia (72.88 për qind), 4. Malisheva (72.88 për qind), 5. Klina (68.66 për qind), 6. Dragashi (64.41 për qind), 7. Kamenica (62.71 për qind), 8. Shtërpça (56.78 për qind), 9. Graçanicë (54.24 për qind), 10. Obiliqi (53.39 për qind), 11. Mamusha (27.12 për qind).

Në hapje të kësaj konference, Ismet Kryeziu, drejtor ekzekutiv i KDI-së, ka theksuar se mungesa e transparencës, pjesëmarrja e mangët e publikut në vendimmarrje dhe etika jo e mjaftueshme në qeverisje nuk janë sfida vetëm për institucionet lokale, por edhe për qeverisjen në nivel qendror.

Ndërkaq ambasadori britanik në Prishtinë, Ruairi

O'Connell, ka theksuar se ky projekt ka të bëjë me pushtetin që qytetarët e mbajnë. Ai ka thënë se thelbi i demokracisë është sundimi nga populli. "Ne kemi një shprehje në Britani që 'dituria është fuqi'. Nëse qytetarët janë të angazhuar në procesin demokratik, fuqia e tyre rritet. Sa më shumë informacion që qytetarët kanë për mënyrën se si përfaqësuesit e tyre po qeverisin, aq më shumë ata mund t'u kërkojnë atyre llogari. Sa më shumë që bëjnë pyetje, aq më të përgjegjshëm bëhen politikanët e tyre. Dituria është fuqi. Dhe dituria e vënë në duart e njerëzve është një gjë e fuqishme. Por, gjithashtu, kjo fuqi nuk ka domethënie nëse nuk përdoret nga njerëzit. Qytetaria aktive është çelësi i demokracisë", ka thënë O'Connell.



zbutur dhe partnerët e koalicionit kanë treguar vendosmëri në vendimet e veta dhe nuk ka genë i vetmuar as kryeministri Haradinaj siç nuk duhet të jetë as tash. Pra, duhet të kemi reflektim të përbashkët, jo vetëm të kryeministrit, por edhe të partnerëve të tjerë të koalicionit, që t'i jepet mundësia procesit dhe paqes, duke e ruajtur interesin tonë strategjik, që është miqësia me ShBA-në.

BE-ja duhet t'ia lejojë Kosovës udhëtimin pa viza



Nga Behgjet PACOLLI

Qytetarët e Maqedonisë, të Serbisë, të Malit të Zi, të Bosnjës dhe Shqipërisë, të gjithë mund të udhëtojnë për në Evropë pa viza. Vendi im, Kosova, mbetet demokracia e vetme evropiane, qytetarëve të së cilës iu mohohet kjo e drejtë.

Ne ende ballafaqohemi me situata të turpshme, ku duhet të aplikojmë për viza (që është një proces i kushtueshëm dhe që merr kohë) thjesht për të shkuar në pushim ose për t'i vizituar të afërmit.

Përfitimet e liberalizimit të vizave janë të shumta, nxitja e partneriteteve ekonomike, promovimi i kontakteve ndërkulturore, përmirësimi i shkëmbimeve profesionale dhe arsimore, madje do të ndihmonë edhe në luftimin e rolit të kontrabandistëve me njerëz, shërbimet e të cilëve nuk do të nevojiteshin më. Parimet që gjenden prapa liberalizimit të vizave janë ato të cilat Bashkimi Evropian deklaroi se i vlerëson

më së shumti - hapja, drejtësia dhe uniteti.

Kemi duruar mjaft duke shikuar se si qytetarët e të gjitha shteteve fqinje të Kosovës kanë fituar të drejtën të udhëtojnë lirisht në zonën Shengen për një periudhë deri 90 ditore. Duke pasur parasysh se 84 për qind e kosovarëve janë të mendimit se anëtarësimi në BE është një gjë e mirë për vendin e tyre, BE-ja nuk mund ta konsiderojë të huaj popullin tonë entuziast. Ka mjaft shumë kriza në Evropë dhe nuk është në të mirë të askujt krijimi i një krize të re.

Para pak kohe kam vizituar Berlinin dhe shumë kryeqytete të tjera të BE-së për të lobuar për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës dhe për t'i arsyetuar përfitimet që do të sillte një vendim i tillë. Ishte inkurajuese përkrahja e fuqishme që na dhe kolegu im, Michael Roth, ministër për Evropën i Gjermanisë.

Marrëdhëniet e Kosovës me BE-në për neve janë strategjike, njësoj si është rajoni i Ballkanit strategjik për BE-në. Kjo është një mundësi e mirë për BE-në që të dëshmojë udhëheqje globale duke adresuar çështjet që janë në 'oborrin' e saj. Kosova dhe Ballkani janë një test për kredibilitetin e BE-së

dhe për pozitën e saj ndërkombëtare.

Prandaj, u bëj thirrje udhëheqësve evropianë t'i validojnë rekomandimet pozitive të bëra nga Komisioni Evropian më 18 korrik të vitit që shkoi, dhe që janë kaluar nga Parlamenti i BE-së, ku konfirmohet se të gjitha kërkesat janë plotësuar. Krejt çka mbetet është që Këshilli Evropian ta miratojë propozimin e Komisionit, për t'i dhënë fund trajtimit të padrejtë që na është bërë.

Ne dëgjojmë se disa shtete anëtare kanë shqetësime lidhur me migrimin e parregullt, dhe që votat kundër të Deputetëve të Parlamentit Evropian nga Franca, Holanda dhe Qipro janë reflektim i opinionit të qytetarëve të tyre përkatës.

Megjithatë, siç edhe demonstrojnë votat pozitive në Komision dhe në Parlament, Kosova ka zhvilluar të gjitha kornizat e nevojshme për ta trajtuar këtë çështje dhe shumë çështje të tjera. Nuk ka asnjë dyshim se në secilën fazë janë plotësuar kërkesat përkatëse. Ky proces, i cili filloi në vitin 2012, është marrë me shumë seriozitet nga të gjithë partnerët. Ne i kemi arritur 95 çaqet që kanë të bëjnë me migrimin, menaxhimin e kufijve dhe sigurimin e të drejtat themelore.

Para pak kohe, Komisioni njohu sukseset tona të mëdha në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Tani duhet ta kalojmë edhe pengesën e fundit. Kam besim se zëri jonë do të dëgjohet, pasi që BE e di se liberalizimi i vizave nga Këshilli Evropian do të sillte përfitime për të gjithë. Në veçanti për të rinjtë e Kosovës, të cilët përbëjnë 60 për qind të popullsisë. Për këta kosovarë, e ardhmja evropiane është e vetmja e ardhme që shohin dhe e vetmja e ardhme që dëshirojnë. Vonimi i mëtejshëm i vendimit nuk do t'i shërbente interesave të BE-së, një gjë e tillë do të dëmtonte rëndë besueshmërinë e premtimeve të saj.

Ne e kuptojmë se me zgjedhjet e reja evropiane dhe ndryshimet në udhëheqjen e Komisionit, si dhe me një numër të zgjedhjeve parlamentare në shtetet anëtare, liberalizimi i vizave për Kosovën nuk është në krye të agjendës. Megjithatë, kjo nuk është arsye e mjaftueshme - shtetet anëtare të BE-së duhet të marrin në konsideratë aspiratat e vendeve që janë jashtë BE-së, por me vështrim brenda saj, dhe ta shfrytëzojnë këtë mundësi për ta ruajtur optimizmin për atë që mund ta ofrojë BE-ja.

Shtetet anëtare nuk duhet të

lejojnë që frika nga një ndjenjë popullore të kontrollojë vendimet e tyre sidomos pas progresit të arritur e të merituar nga evropianët. Për më tepër, migrimi i parregullt është një shqetësim për të gjithë neve, të cilin mund ta trajtojmë së bashku dhe të mos ta ndërlikojmë me qytetarët, që i binden ligjit dhe të cilët dëshirojnë t'i zgjerojnë horizontet e tyre në mbarë kontinentin, pjesë e të cilit ndihen se janë.

Shumë deputetë evropianë kanë ngritur zërin për përkrahje të liberalizimit të vizave dhe kanë inkurajuar Këshillin, që të ndërmarrë hapa aktivë për miratimin e finalizimit. Kjo mbështetje vlerësohet lart, por për ta arritur pragun e caktuar, duhet që vetë politikanët kombëtarë të bëjnë thirrje dhe të pranojnë se ne kemi punuar pa pushim që t'i përmbushim të gjitha kriteret e kërkuara.

Tani është koha e duhur për të bërë gjënë e drejtë dhe të duhur duke shpërblyer këto angazhime. Kur bëhet një premtimi ai duhet edhe të nderohet.

(Artikulli i zëvendëskryeministrit të parë dhe ministrit të Jashtëm, Behgjet Pacolli, është botuar në "Euroactiv" më 12 shkurt 2019)

Haradinaj: Mirënjohës për kontributin e komunitetit ashkali në procesin e lirisë dhe shtetndërtimit

PRISHTINË, 13 SHKURT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë të mërkurën në pritjen e organizuar me rastin e Ditës së Flamurit të komunitetit ashkali, të organizuar nga Zyra për Çështje të Komuniteteve e Zyrës së Kryeministrit. Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryeministri Haradinaj ka thënë se arsyeja që i ka bërë bashkë është se, më 15 shkurt është Dita e Flamurit të komunitetit ashkali, duke vlerësuar se këtë ditë e kanë kthyer në festë të përbashkët, traditë ku festohet së bashku. "Unë jam shumë i gëzuar që shtëpia e qytetarëve të Kosovës, në këtë rast Qeveria e Kosovës, është vendi ku bashkohemi kaq shumë dhe me kaq dashuri për ta shprehur respektin për komunitetin ashkali në Kosovë", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se komuniteti ashkali është një prej komuniteteve më të vjetra në Kosovë dhe se çdoherë ka qenë bashkë me të tjerët me shqiptarët, serbët, turqit, romët, egjiptasit, goranët, boshnjakët. Më tej, kryeministri Haradinaj ka



shtuar se është mirënjohës për kontributin e këtij komuniteti si në procesin e lirisë dhe tani në atë të shtetndërtimit. Duke vlerësuar se pritjet e këtij komuniteti janë më të mëdha, kryeministri

Haradinaj premtoi se bashkë me deputetët e këtij komuniteti dhe zëvendësministrat do të bëjnë punë të mira, që t'i gëzojnë të drejtat që i kanë me Kushtetutë dhe me ligj, por edhe për rritjen e

mirëqenies ekonomike, sociale dhe kulturore.

Ndërsa deputeti Etem Arifi, pasi uroi të gjithë popullin ashkali në Kosovë dhe diasporë për Ditën e Flamurit Kombëtar, vlerësoi se

janë mirënjohës ndaj UÇK-së, bashkësisë ndërkombëtare, BE-së, ShBA-së dhe NATO-s për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, duke thënë se ndihen krenarë që janë disa deputetë nga ky komunitet që kanë nënshkruar deklaratën e pavarësisë. "Kjo festë e ashkalinjve të Kosovës i gjen me mbështetje institucionale dhe me përkrahje të atyre që kanë nevojë, kanë arsim më të mirë, banim më të mirë dhe kanë jetë më të mirë krahasuar me gjendjen e mëhershme", ka thënë deputeti Arifi, duke kërkuar nga kryeministri Haradinaj mbështetjen e tij edhe në të ardhmen për këtë komunitet.

Edhe deputeti Danush Ademi ka thënë se janë falënderues ndaj kryeministrit Haradinaj për përkrahjen e këtij komuniteti për rregullimin e infrastrukturës dhe shtëpi më të ngrohta. Më tej, deputeti Ademi ka vlerësuar se janë mbi 10 mijë nxënës që ndjekin mësimet nga ky komunitet, ka pjesëtarë që shërbejnë në ushtrinë e Kosovës, duke thënë se do të jenë përkrahës të të gjitha proceseve në Kosovë.

I jepet lamtumira e fundit akademik Idriz Ajetit

Në varrezat e qytetit të Prishtinës të mërkurën i është dhënë lamtumira e fundit akademik Idriz Ajetit. Në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (AShAK) janë bërë homazhe dhe është mbajtur mbledhje përkujtimore për nder të veprimtarisë së Idriz Ajetit. Përfaqësuesit e institucioneve të vendit dhe akademikë kanë vlerësuar kontributin e Ajetit dhënë në jetën shkencore, kulturore dhe politike në vendin tonë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 SHKURT - Të mërkurën në varrezat e Prishtinës i është dhënë lamtumira e fundit akademik Idriz Ajetit, i cili ka ndërruar jetë në moshën 102-vjeçare. Në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (AShAK) janë bërë homazhe dhe është mbajtur mbledhje përkujtimore për nder të veprimtarisë së Idriz Ajetit. Kryetari i ASHAK-ut, Nexhat Daci, ka thënë se janë krenarë që akademik Ajetin e patën koleg, mik dhe udhëheqës për një kohë të gjatë. "Asnjëherë në asnjë periudhë akademik Ajeti nuk e ka lëshuar rrugën e drejtësisë kombëtare dhe intelektuale. E kemi pasur gjithmonë në përkrahje", ka thënë Daci. Ndërsa akademik Rexhep Ismaili foli për jetën dhe veprën e Idriz Ajetit, duke thënë se ai ishte doajen i dijes albanistike. Familjes Ajeti telegrame ngushëllimi i kanë dërguar liderët shtetërorë. Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se vdekja e akademikut Idriz Ajeti është një humbje e madhe për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të

Kosovës dhe tërë shoqërinë tonë. "Profesorin Idriz Ajeti do ta kujtojmë gjithmonë si një prej intelektualëve më të dalluar, që punoi shumë për albanologjinë. Ai dha kontribut të madh në jetën shkencore dhe kulturore në vendin tonë. Ngushëllimet më të thella për familjen Ajeti, ASHAK-un dhe gjithë kolegët e miqtë e akademikut Idriz Ajeti!", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ngushëllime familjes Ajeti i ka shprehur edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. "Themelimi i albanologjisë, ndërtimi i institucioneve tona akademike kosovare, mbrojtja dhe konsolidimi i gjuhës shqipe në trojet tona, lidhen ngushtë me jetën dhe veprën e akademik Idriz Ajetit. Me këtë rast ngushëlloj familjarët, të afërmit, kolegët dhe bashkëpunëtorët e tij", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se bota shqiptare humbi sot njërin nga personalitetet më të ndritshme të historisë sonë të re, albanologun e shquar Idriz Ajeti. "Gjatë 70 vjetëve karrierë shkencore akademik Ajeti la gjurmë të pashlyshme në gjuhësinë dhe

zhvillimet shoqërore dhe politike të Kosovës. Kontributi i tij në vitet '90 ishte i jashtëzakonshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe të vërtetës së Kosovës. Kalimi i tij në amshim është humbje për shkencën dhe kulturën mbarëshqiptare. Ngushëllime të thella familjes Ajeti, komunitetit akademik dhe miqve të shumtë", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Telegram ngushëllimi për familjen Ajeti ka dërguar ministri i Arsimit, Shyqri Bytyqi. "Lajmi për ndarjen nga jeta të akademik Idriz Ajetit ishte i dhembshëm për të gjithë ne dhe një humbje e madhe për arsimin dhe shkencën. Me punën e tij të palodhshme akademik Ajeti u bë një nga figurat më të rëndësishme të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, një nga figurat më të dashura të gjeneratave të shumta të Universitetit të Prishtinës. Ai u bë një nga figurat më të rëndësishme të historisë shqiptare. Emri i akademik Ajetit do të mbetet një nga emrat më të mëdhenj të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare, një nga emrat më të mëdhenj të rrugëtimit të Kosovës drejt lirisë dhe shtetësisë", është thënë në telegramin ngushëllues të ministrit Bytyqi.



BIOGRAFIA E IDRIZ AJETIT

Lindi në Tupallë të Jabllanicës së Epërme më 27 janar 1917. Shkollën fillore e kreu në Banjë të Sijarinës, të mesmen në Shkup, më 1938. Po atë vit u regjistrua në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Zagrebit, në Degën e Romanistikës. Studimet i mbaroi pas luftime, më 1949, në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Beogradit. Deri në vitin 1953 ishte profesor i gjuhës shqipe në Gjinnazin e Prishtinës. Në vitet 1953-1960 punoi lektor në Degën e Albanologjisë në Beograd. Në vitin 1958 doktoroi me temën: "Zhvillimi historik i së folmes geqe të shqiptarëve të Zarës së Dalmacisë". Nga viti 1960 ka dhënë mësim në Degën e Gjuhës e të Letërsisë Shqipe në Fakultetin e Filozofisë të Prishtinës, një herë docent, pastaj profesor inordinar dhe nga viti 1968 profesor ordinar. Fushat kryesore të interesimit të tij shkencor kanë qenë studimet e dialekteve nga pikëpamja diakronike, raportet e shqipes me gjuhët fqinje, në rrafshin e studimeve ballkanologjike, trajtimi i dokumenteve të hershme gjuhësore, shkruar me alfabet arabo-turk etj. Është marrë edhe me çështje të gjuhës së sotme shqipe dhe ka organizuar takime e konsulta gjuhësore për t'i kërkuar zgjidhjet e përhershme rreth njësisimit të gjuhës shqipe. Prof. Ajeti ka merita të veçanta në proceset e standardizimit të shqipes. Veprimtaria e tij shkencore është e gjerë dhe e gjithanshme. Në Prishtinë, Tiranë e gjetiu janë botuar vëllime me studime të zgjedhura të tij. Ka hartuar tekste shkollore për

nxënës të shkollave të mesme e studentë të Degës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe. Në vitet 1997-2002 Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës botoi veprën e tij të plotë në pesë vëllime. Në bibliografinë e tij gjejmë qindra artikuj, studime, kumtesa të mbajtura në Konferenca shkencore, seminare, takime kombëtare e ndërkombëtare, të botuara në revista e perioidikë në shqip, por edhe në gjermanisht, frëngjisht apo në gjuhë të tjera.

Me nismën e tij, si shef i Departamentit të Gjuhës Shqipe pas hapjes së Fakultetit në Prishtinë (1960), u nxor revista shkencore "Gjurmime albanologjike" (1962) e më 1974 u organizua Seminari i Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare për të Huaj. Gjatë vitit 1969-1971 ishte drejtor i Institutit Albanologjik, më 1971-73 dekan i Fakultetit Filozofik, në vitet 1973-'75 rektor i Universitetit të Prishtinës. Anëtar i ASHAK-ut u zgjodh me gjeneratën e parë ta akademikëve dhe menjëherë mori titullin akademik, ndërsa në vitin 1979 u zgjodh kryetar i saj deri më 1981. Më 1996 ai do të rizgjidhet kryetar dhe do ta drejtojë Akademinë deri më 1999.

Prania e Idriz Ajetit në jetën shkencore e kulturore si dhe në të gjitha zhvillimet shoqërore ka qenë e dukshme dhe thelbësore. Puna e tij është shtrirë edhe në fushën e të drejtave të njeriut dhe në veprimtarinë shoqërore. Akademik Idriz Ajeti ka qenë kryetar i Kuvendit të Kosovës në njërin nga periudhat më të vështira të saj si dhe pjesëmarrës i Konferencës së Rambujesë.



Thaçi dekoron Sabri Fejzullahun me Medaljen Presidenciale të Meritave

PRISHTINË, 13 SHKURT (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, e ka dekoruar të mërkurën me Medaljen Presidenciale të

Meritave, për kontributin dhënë në fushën e artit, këngëtarin Sabri Fejzullahu. "Me Medaljen Presidenciale të Meritave e dekorova një prej këngëtarëve

më të pëlqyer të publikut tonë për më shumë se gjysmëshekulli. Gati tërë jetën e tij Sabriu na ka argëtuar me këngë dhe humor. Na ka treguar bukuritë e

jetës, por edhe na ka bërë të mendojmë për detyrat dhe obligimet për shoqërinë tonë", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".



Lëvizja Vetëvendosje: Degët e pushtetit, në Telekom

PRISHTINË, 13 SHKURT (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka organizuar të mërkurën aksion simbolik para objektit të Telekomit të Kosovës për ta vazhduar denoncimin e shfrytëzimit partiak të kësaj ndërmarrjeje publike. Pas aksionit të ngjijtes së parullave, ku shkruheshin emrat e partive kryesore në pushtet dhe poshtë tyre fraza "dega Telekom", anëtarja e Kryesisë së Qendrës së Lëvizjes në Prishtinë, Rinë Zhitia, ka thënë se subjektet e koalicionit qeverisës PDK, AAK dhe Nisma e kanë bërë Telekomin e vendit si degë të tyre partiake, ku rehatohen njerëzit dhe klientela e tyre. "Meqenëse vetëm kohët e fundit janë bërë qindra punësime të tilla, ne sot, në mënyrë simbolike, po vendosim logot e këtyre partive me

degën e tyre në Telekom, sepse sot hapësirat e punës së Telekomit janë shndërruar në zyrë të partive në pushtet", ka thënë ajo.

Rinë Zhitia i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës ta zbatojë Rezolutën e Kuvendit të Kosovës të nxjerrë në verën e vitit të kaluar, e cila thotë saktësisht të kundërtën e kësaj që po bën aktualisht kjo Qeveri. "Po ashtu, Prokurorisë i bëjmë thirrje t'i fillojë hetimet e menjëhershme në lidhje me këtë skandal të punësimeve pa kriter, pa nevojë dhe me qëllim të shkatërrimit të Telekomit. Telekomit ka potencial për t'u zhvilluar financiarisht dhe për t'u zgjeruar në tregun e Kosovës. Privatizimi i Telekomit është privatizim i fitimit dhe nacionalizim i humbjes", ka



Produktet e Kosovës prezantohen në Panairin e Ushqimeve Organike në Nuremberg



NUREMBERG, 13 SHKURT (ER) - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), ka organizuar pjesëmarrjen e pesë kompanive të Kosovës në Panairin "Biofach" që po mbahet në Nuremberg të Gjermanisë. "Eurofruti", "Fungo", "OrganicHerb", "Agroproduct"

dhe "Hit-Flores" janë kompanitë e Kosovës që janë duke i promovuar produktet e tyre, si: fruta mali, bimë mjekuese, aromatike etj., para blerësve dhe vizitorëve nga shtete të ndryshme pjesëmarrëse në këtë panair.

"Biofach" është panair në të cilin promovohen ushqimet organike. Ky panair është një mundësi e mirë për kompanitë e Kosovës që të takohen me prodhues profesio-

sionalë të ushqimit organik dhe të njihen me trendet e fundit të këtij sektori. Panairi do të jetë i hapur më 13 e deri më 16 shkurt në Nuremberg të Gjermanisë.

Rekomandohet që mjetet e Trustit të investohen në Kosovë



Kryesuesi i Bordit të Trustit, Ruzhdi Morina, ka thënë se Fondi ka pasur performancë negative përreth 35 milionë euro, megjithëkëtë ai ka thënë se qytetarët e Kosovës duhet të ndihen të qetë pasi, sipas tij, nuk ka nevojë për shqetësime. Ndërkaq rreth rekomandimeve që paratë e Trustit të investohen në Kosovë, Morina ka thënë se është rekomandim i mirëpritur, por duhet krijuar infrastrukturë ligjore

**EPOKA
ERE**

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 SHKURT - Bordi Drejtues i Fondit të Kursimeve Pensionale ka raportuar të mërkurën në Komisionin për Buxhet dhe Financa lidhur me zhvillimet e fundit në tregjet financiare sa iu përket mjeteve pensionale.

Kryesuesi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, ka deklaruar se rënia që ka ndodhur prej 5.3 përqindësh cilësohet ndër rëniet më të mëdha që nga kriza e vitit 2008 dhe 2009. "Trusti ka 1.7 miliard euro në menaxhim dhe të investuara në tregje financiare. Rënia e tyre prej 5.3 përqindësh është rënia më e madhe që nga kriza e vitit 2008. Trusti dhe insti-

tucionet tona kanë obligim t'i përcjellin zhvillimet dhe t'i parashikojnë zhvillimet e ardhshme në mënyrë që të marrin hapa dhe të parandalohen rëniet e tilla", u shpreh ai.

Kryesuesi i Bordit të Trustit, Ruzhdi Morina, ka thënë se Fondi ka pasur performancë negative përreth 35 milionë euro, megjithëkëtë ai ka thënë se qytetarët e Kosovës duhet të ndihen të qetë pasi, sipas tij, nuk ka nevojë për shqetësime. "Qytetarët duhet të jenë të qetë sepse situata është nën kontroll dhe nuk ka nevojë për panik. Fondi bën investime të kursimeve pensionale në parimet e përcaktuara me ligj dhe sigurojmë kthim nga këto investime. Viti 2018 ka qenë vit interesant sa iu përket parametrave ekonomikë.

Të gjithë parametrat kanë qenë të ngjashëm si në vitin 2017. Investimet që kanë ardhur në vitin 2018 janë realizuar dhe kjo ka ndikuar që protokoli i investimeve të rritet 20 për qind", u shpreh Morina.

Në këtë mbledhje u rekomandua që të krijohet infrastruktura ligjore dhe që mjetet e Trustit të investohen në Kosovë. Naser Osmani nga LDK-ja ka thënë se do të ishte mirë që mjetet e Trustit të investoheshin në Kosovë, përkatësisht në sektorin energjetik. Rekomandimi i Osmanit është mirëpritur edhe nga kryesuesi i Bordit të Trustit, Ruzhdi Morina, i cili ka kërkuar infrastrukturë ligjore për këtë. "Do të ishim të lumtur t'i investonim këto para edhe ne në Kosovë po sikur një që të tillë e bën edhe

Kroacia në shtetin e vet dhe nuk u ekspozohet rreziqeve të tregjeve ndërkombëtare", u shpreh Morina.

Kurse zëvendësguvernatori i BQK-së, Sokol Havolli, ka thënë se të gjithë operatorët në tregun e pensioneve kanë pasur performancë negative. "BQK-ja në baza të rregullta vjetore zhvillon ekzaminime të përgjithshme të operatorëve të pensioneve. Konstatimi im është se të gjithë operatorët në tregun e pensioneve kanë pasur performancë negative. Synimi ynë është që bashkë me komisionin dhe Trustin t'i avancojmë strategjitë investive për krijimin e portofolave të ndryshëm dhe të ruhen grupmoshat e pensionimit", ka thënë Havolli, duke shtuar se BQK-ja vazhdimisht është treguar bashkëpunuese për zhvillimin e industrisë financiare. "Tani jemi duke zhvilluar kornizën ligjore për krijimin e fondeve të investimeve, jo vetëm të mjeteve në Trust, por cilitdo qytetar që ka kapacitete investive", shtoi Havolli.

Deputeti i PSD-së, Dardan

Molliqaj, ka thënë se kemi të bëjmë me investime të gabuara që kanë të bëjnë vetëm me mbulimin e inflacionit. "Rënie-ngritjet janë dukuri që mund të menaxhohen mirë apo keq për shkak të problemeve në treg. Ne kemi mbulim të inflacionit dhe ky është investim total i gabuar. Ne po investojmë para vetëm sa për ta mbuluar inflacionin. Kjo është rënie apo humbje e madhe", ka thënë Molliqaj, duke kërkuar vëmendje nga Trusti dhe BQK-ja. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka mbetur ta shqyrtojë edhe një herë raportin plotësues me amendamente të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit. Po ashtu, u formua grup punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për financimin e subjekteve politike, të përfaqësuar nga Dardan Molliqaj, Mërgim Lushtaku, Naser Osmani, Arbërie Nagavci dhe Fikrim Damka.

Bizneset indiane shprehin interesim të vijnë edhe në Kosovë

PRISHTINË, 13 SHKURT (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka pritur të mërkurën në takim kryetarin e Odës Ekonomike Indiane, Asif Iqbal, që temë diskutimi ishte thellimi i bashkëpunimit në mes dy shteteve në fushën e ekonomisë dhe shkëmbimeve tregtare. Ministri Shala e ka informuar delegacionin e Odës Ekonomike Indiane për mundësitë që i ofron Kosova për investitorët e huaj dhe Ligji për Investime Strategjike që është duke u aplikuar tashmë dhe ka sjellë efekte të jashtëzakonshme. Po në takim u diskutua për mundësitë e shumta që i ofron Kosova për investime në fushën e energjisë, teknologjisë, bujqësisë, turizmit etj.

Ministri Shala ka thënë se Kosova



ofron kushtet më të favorshme në rajon për investime si rezultat i Ligjit për Investime Strategjike dhe, po ashtu, ndryshimeve të fundit që janë bërë në këtë ligj, që krijojnë lehtësira edhe më të mëdha për investitorët. "Potenciali i Kosovës është i jashtëzakonshëm. Kemi një rini shumë inovative dhe krijuese. Po ndërtojmë zona ekonomike nëpër vendet kryesore të Kosovës që investitorëve të huaj t'ua sigurojmë edhe vendin me një qira shumë modeste", ka deklaruar ministri Shala.

Kryetari i Odës Ekonomike Indiane, Asif Iqbal, ka theksuar se bizneset indiane kanë interes të shtrihen në rajonin e Ballkanit, edhe në Kosovë, për të investuar në fushën e teknologjisë.

Skenderaj hyn në garë për grantin e performancës për mjedis të pastër

PRISHTINË, 13 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe GIZ-in gjerman për grantin e performancës për mjedis të pastër. "Me nënshkrimin trepalësh të memorandumit të mirëkuptimit (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Organizata GIZ dhe Komuna e Skenderajt), kemi hyrë në garë për grantet e performancës për mjedis të pastër, të cilat ndahen nga Ministria e Mjedisit dhe GIZ-i gjerman. Më vjen mirë që

si komunë jemi klasifikuar në kategorinë e komunave të Kosovës me performancë të kënaqshme mjedisore", ka thënë Jashari. Me këtë rast, Jashari ka falënderuar ministrin e MMPH-së, Fatmir Matoshi, dhe zyrtarët nga GIZ-i për këtë vlerësim. "Shpreh bindje se ne kemi ndërmarrë veprime konkrete në nivel komunal dhe këtu dua t'i përmend dy aksionet e mëdha të pastrimit dhe eliminimit të deponive ilegale. Shfrytëzoj rastin t'u bëj thirrje të gjithë qytetarëve të Skenderajt, që secili të japë kontribut për ruajtjen e mjedisit në të cilin jetojmë", është shprehur Jashari.



Safet Kamberi zgjedhet kryesues i Kuvendit Komunal në Mitrovicë

MITROVICË, 13 SHKURT (ER) - Nën drejtimin e kryesuesit, Safet Kamberi, në prani të kryetarit të komunës, Agim Bahtiri, nënkryetarit Faruk Mujka dhe drejtorëve të drejtorive të administratës komunale, të mërkurën është mbajtur mbledhja e 17 e rregullt e Kuvendit të Komunës. Fillimisht mbledhja u kryesua nga asamblisti më i vjetër në Kuvend, Gani Haliti, i cili propozoi rendin e ditës për seancën e 17 të kuvendit, me ç'rast këshilltarët komunalë

unanimisht aprovuan këtë rend dite.

Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës, zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, u propozua vetëm një kandidat për këtë pozitë, ku në emër të asamblistëve të LDK-së, Flutura Beka-Kamberaj, propozoi asamblistin Safet Kamberi për kryesues të Kuvendit. Në procesin e votimit morën pjesë gjithsej 32 asamblistë komunalë. Pas numërimit të votave nga komisioni për mbikëqyrjen e procesit të votimit, Safet

Kamberi nga radhët e LDK-së me 19 vota për u zgjodh kryesues i Kuvendit Komunal. Me këtë rast, kryesuesi i porsazgjedhur, Safet Kamberi, falënderoi asamblistët për besimin e dhënë dhe premtoi se do ta ruajë frymën e mirë dhe demokratike të punës dhe se do të jetë bashkëpunues me të gjithë këshilltarët e Kuvendit të Komunës. Në këtë mbledhje me disa vërejtje dhe sugjerime, me shumicë votash, u miratuan të gjitha pikat e rendit të ditës.



të nisë nga 19 shkurti i këtij viti. Ai tha se janë hartuar udhëzuesit dhe rregulloret për të gjitha fushat të cilat do të jenë bazë për procesin e garës. Në takim morën pjesë të gjithë drejtorët e shkollave të komunës në krye me drejtorin komunal të arsimit,

Mensur Neziri. "Zotohem se do ta keni përkrahjen institucionale për implementimin e programit. Është edhe një mundësi e mirë që nxënësit tanë të garojnë me shkollat tjerë në nivel republikane, andaj ju jemi mirënjohës për mbështetjen që ky program

po realizohet edhe në Komunën e Shtimes", ka thënë drejtori Neziri. Programi Nacional për Rininë do të zbatohet në tri fusha: Kreativitet Kulturor dhe Mendim Kritik, Dituri dhe Sport për të gjithë nxënësit dhe studentët.

Komuna e Shtimes e gatshme për zbatimin e Programit Nacional për Rininë

SHTIME, 13 SHKURT (ER) - Në kuadër të takimeve me drejtorët e shkollave të komunave, sot në Komunën e Shtimes është prezantuar Programi Nacional për Rininë, i hartuar nga Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Për programin foli zëvendësimistria për Kulturë, Rini dhe Sport, Leonora Morina-Bunjaku, e cila theksoi mbështetjen që MKRS-ja

jep për këtë program. "Ky program do t'i kontribuojë arsimit dhe kulturës në përgjithësi, pasi që të gjithë nxënësit do të kenë mundësi t'i realizojnë aftësitë dhe shkathtësitë nëpërmjet garës edhe në Komunën e Shtimes", ka thënë Morina-Bunjaku.

Ndërkaq përfaqësuesi i Koordinatorit Nacional për Kulturë, Amir Demiri, ka shpjeguar në detaje programin dhe i ka informuar drejtorët se gara do

Shpërndahen 40 makina për mbjelljen e grurit për fermerët malishevas

MALISHEVË, 13 SHKURT (ER) - Të mërkurën është bërë shpërndarja e 40 makinave për mbjelljen e grurit për bujqit e Komunës së Malishevës. Shpërndarjen e këtyre makinave për bujq e kanë vëzhguar nga afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha dhe drejtori për Bujqësi, Murat Hoxha. Nënkryetari i Komunës së

Malishevës, Hajdin Berisha, duke i përgëzuar bujqit përfitues, ka theksuar se qëllimi i komunës është rritja e kapaciteteve dhe krijimi i kushteve sa më të mira për bujqit. "Bujqësinë e konsiderojmë fushën më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik", ka thënë nënkryetari Berisha gjatë takimit me bujqit përfitues. Ndërsa drejtori i bujqësisë, Murat Hoxha, ka thënë se në vazhdimësi

janë duke u munduar që brenda mundësive buxhetore t'i përkrahin bujqit në të gjitha format e mundshme, me qëllim të zhvillimit sa më të madh të bujqësisë, ku Malisheva njihet si trevë bujqësore. Ky projekt shumë i rëndësishëm për fermerët e Komunës së Malishevës është realizuar nga buxheti i Komunës së Malishevës si dhe me participimin e fermerëve.



Pavarësia e Kosovës në dekadën e dytë



Salihe SALIHU -
PhD kandidat

Kosova shtet i pavarur dhe sovran hyri në dekadën e dytë me sfida të reja. Tani në këtë 11-vjetor të Kosovës sovranë jemi në një prag sa të mundshëm aq edhe sfidues për arritjen drejt caktit të dëshiruar. Ky dualitet shfaqet meqë shumëçka që është e mundshme dhe tërësisht në harmoni me vullnetin dhe nevojat e Kosovës has në pengesa në rrugëtim e sipër. Në këtë vështrim së pari dihet se vullneti i popullit të Kosovës është që në dekadën e dytë të prezantohemi si një shtet sovran me kapacitete të fuqishme. Së dyti, krahas vullnetit, ndihet nevoja që Kosova ta ketë portretin e vet të pastër si shtet sovran dhe me këtë të mbajë një imazh të mirë në arenën ndërkombëtare. Mirëpo, që të dyja këto aspirata janë penguar dhe janë vënë në sprovë. Pengesat dhe shkaktarët që pengojnë për ta fuqizuar edhe më tej sovranitetin e Kosovës ndahen në dy kategori. Në kategorinë e parë hynë faktorët e

brendshëm, në kategorinë e dytë hynë faktorët e jashtëm.

1. Në kategorinë e parë grupohen marrëdhëniet në mes të partive politike dhe sjelljeve të tyre karshi sovranitetit të Kosovës. Të gjitha partitë shqiptare dhe minoritare, përveç Listës Serbe, janë të unifikuar për mbrojtjen dhe fuqizimin e sovranitetit të Kosovës në ecjen e saj në dekadën e re. Mirëpo në deklaratimet dhe sjelljet e tyre kanë një diskongruencë të dukshme. Sjelljet e disa politikanëve kanë nevojë të rikorrigjohen dhe të jenë në përputhje me deklaratimet e tyre sepse, përndryshe, i ngjason shprehjes së moçme të hoxhallarëve: "Bëj çka të them unë, por mos bëj çka bëj unë". Kredibiliteti i disa aktorëve politikë është zbehur në masë të gjerë. Mjerisht, disa politikanë me sjelljet e tyre, si në sferën private dhe në atë publike, qysh në dekadën e parë kanë humbur totalisht kredibilitetin e tyre për të qenë prijës apo për të vazhduar të jenë përfaqësues të popullit në vijimësinë e dekadës së dytë. Prijësit e dekadës së dytë të sovranitetit të Kosovës duhet të jenë prijës apo politikanë/e që dëshmojnë se janë të devotshëm në mbrojtje të vlerave demokratike dhe me shembullin e tyre personal të krijojnë një kulturë të respektimit të kodeve moralo-etike në rrafshin privat dhe publik. Me këto cilësi do të

rritet kredibiliteti i tyre para popullit dhe do të fuqizohet zëri i tyre si përfaqësues. Ecja dhe veprimet e drejtpeshuara pa cenimin e kodeve moralo-etike dhe ruajtja e kultivimi i tyre është bazamenti dhe busulla që duhet të jetë e përdorshme në përditshmërinë e sjelljeve të politikanëve të cilët, mbi gjithçka, duhet të mendojnë në radhë të parë për fuqizimin e sovranitetit të Kosovës. Duke e ngrehur kredibilitetin dhe duke përfaqësuar dinjitetshëm, do të jemi zëri me sovranitet më të fuqishëm ndaj çdo sfide që do të përballemi për ta fuqizuar dhe për ta ranguar Kosovën sovranë me imazh të mirë në arenën ndërkombëtare.

2. Në kategorinë e dytë grupohet marrëdhënia në nivel ndërkombëtar, ku duket qartazi se Kosova në njërin anë ka miq, por ka edhe armiq të përbetuar shekullorë të cilët në të gjitha format e tyre tentojnë ta bllokojnë sovranitetin e Kosovës nga çdo zhvillim progresiv. Serbia në koordinim me Rusinë janë fiksuar për ta rrënuar sovranitetin e Kosovës. Në këtë betejë Serbia dhe Rusia i kanë puq interesat e tyre duke unifikuar veprimet e tyre që t'i përmbushin interesat e tyre. Këto dy shtete me qëllime obstruksioniste kanë investuar për një luftë speciale të rafinuar mediatike kundër sovranitetit të Kosovës për të fituar epërsi dominuese në dy rrafsh. Në njërin rrafsh Rusia synon që

përmes Serbisë ta ketë ndikimin politik dhe të pozicionohet si një fuqi dominuese në Ballkan. Në vazhden e këtyre përpjekjeve, duke shfrytëzuar pakënaqësitë e qytetarëve ndaj parregullive të qeverisjeve në shtetet respektive, kanë shpërthyer trazira. Rusia arriti të nxisë dhe mobilizojë masa protestuesish në disa shtete. Protesta e të pakënaqurave shpërthenin sa në njërin shtet për të vazhduar në shtetin tjetër, për shembull në Mal të Zi, Maqedoni, Shqipëri dhe Serbi. Makineria mediatike e përsosur ruso-serbe me këto manovra është unifikuar për destabilizim sa më të gjerë jo vetëm në Ballkan, por edhe në Evropë dhe me këtë, në fakt, ka arritur deri në një farë shkalle që ta çekuilibrojë diskursin politik në nivel ndërkombëtar. Momentalisht ky çekuilibrim është goxha evident në Unionin Europian por, megjithëkëtë, kjo goditje nuk arriti ta përmbysë gjithë procesin e nisur, ndonëse e pengoi shtimin e politikës evropiane për t'i dëshmuar kapacitetet e veta vendimmarrëse. Gjendja e tanishme ndërkombëtare është analogjike me gjendjen gjatë Luftës së Ftohtë, kur poli demokratik me polin komunist zhvilluan luftë të ftohtë duke iu shmangur luftës frontale deri në rënien e murit të Berlinit. Ndërsa tani, skenari i së ardhmes evropiane duket shumë konfuzional dhe me një pamje të ngrysur. Prandaj

nevojitet një ndriçim dhe vendosmëri për të qëndruar përballë çdo tensionimi që po shfaqet në dimensionin e marrëdhënieve të superfuqive dhe influencave të tyre. Ballkani si rajon me prejardhje konfliktuozë duhet të jetë tejet i kujdesshme për mbajtjen e balancimit të marrëdhënieve ndëretnike e ndërrajonale si dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Mirëpo, sado që gjendja duket se është përkeqësuar, procesi i integrimeve po vazhdon. Republika e Maqedonisë Veriore po dëshmon se, pavarësisht prej vështirësive, është i mundshëm marshimi drejt rrugës së integrimeve. Porse, në këtë proces Kosova sovranë po qëndron në "standby" për ta shtuar ecjen e saj në këtë proces integrues sikurse shteti fqinj.

Pa asnjë hezitim, Kosova sovranë në dekadën e dytë duhet të jetë më proaktive dhe të demonstrojë një politikë më këmbëngulëse për fuqizimin e sovranitetit gjatë vitit 2019, vit që simbolizon 100-vjetorin e Marrëveshjes së Paqes me Traktatin e Versajës të vitit 1919, duke insistuar që të arrihet marrëveshje përfundimtare që do ta sigurojë paqen në mes të Serbisë dhe Kosovës.

Lufta e paqes është më e vështirë se lufta e armatosur, por është imperative për ekzistencën e sovranitetit të Kosovës.

Për 24 orë në Klinikën Emergjente, 224 raste

Prishtinë, 13 shkurt (ER) - Në Klinikën Emergjente të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) në 24 orët e fundit ka pasur gjithsej 224 raste. Prej tyre, 42 pacientë në dhomën e kujdesit të avancuar emergjent, 62 raste kirurgjike, 77 raste internistike dhe 35 ortopedike. Po ashtu, kishte gjithsej dhjetë raste të aksidenteve në trafik dhe dhjetë ndërhyrje në Dhomën e Intervenimeve të Vogla Kirurgjike. Për trajtim të mëtejshëm në klinikat e QKUK-së u pranuan 20 pacientë, nëntë në degët kirurgjike, dhjetë në Internistikë dhe një në Ortopedi.

Edhe Emergenca Pediatrike e Klinikës së Pediatriisë për 24 orë ka pasur gjithsej 91 fëmijë që kanë kërkuar ndihmë mjekësore. 31 fëmijë janë pranuar për trajtim të mëtejshëm në reparte të ndryshme të klinikës. Pediatrit kanë ofruar 99 kontrolle në kuadër të ambulancave specialistike.



ShBA-ja furnizon Libanin me raketa laser

LIBAN, 13 SHKURT - Ambasada amerikane në Liban njoftoi se Shtetet e Bashkuara kanë furnizuar ushtrinë libaneze me raketa laser me një vlerë mbi 16 milionë dollarë. Në një deklaratë të saj thuhet se raketat e dorëzuara të mërkurën janë një

komponent kyç për një flotilje aeroplanësh luftarakë A-29 "Super Tucano" që u janë dorëzuar më parë autoriteteve libaneze. "Kjo demonstroi angazhimin e fortë e të qendrueshëm të Qeverisë amerikane për ta mbështetur Ushtrinë

libaneze në kapacitetin e saj si mbrojtësja e vetme legjitime e Libanit", thuhet në njoftim.

Komenti dukej se i referohej organizatës Hezbollah që mbështetet nga Irani, një grupim që dominon politikën e vendit dhe që disponon një arsenal që

konkurron me atë të ushtrisë libaneze. Gjatë një vizite këtë javë ministri i Jashtëm iranian Mohammad Javad Zarif ofroi ndihmën ushtarake të vendit të tij për Libanin, por tha se Qeveria libaneze duhej të tregonte së pari "gatishtërinë" për ta pranuar atë.



Presidenti Trump i vendosur për ndërtimin e rrethojës kufitare

"Nuk jam i kënaqur me marrëveshjen. Nuk e bën punën e duhur, por unë do të gjej fonde të tjera. Ne kemi për të ndërtuar një mur të mrekullueshëm, të fortë, që nuk do t'i lejojë kriminelët, trafikantët e drogës dhe drogat të hyjnë në vendin tonë", tha presidenti Trump



WASHINGTON, 13 SHKURT - Presidenti Donald Trump këmbëngul se muri në kufirin me Meksikën do të ndërtohet edhe nëse Kongresi nuk i miraton të gjitha fondet që ai kërkon. Udhëheqësit në Kongres thanë të martën se kanë arritur një marrëveshje për buxhetin federal dhe po i kërkojnë presidentit që ta nënshkruajë atë. Trumpi tha se ai nuk është i kënaqur me marrëveshjen, por do të marrë një vendim për miratimin e saj, pasi të njihet me hollësitë. Të dyja palët kanë bërë lëshime për të bërë të mundur marrëveshjen mbi buxhetin.

Marrëveshja e kompromisit nuk përfshin 5,7 miliardë dollarët që kërkoi presidenti Trump për ndërtimin e një muri të ri prej 350 kilometrash, por ajo përfshin 1.4 miliardë dollarë për një gardh prej çeliku prej 90 kilometrash, që do t'i shtohet gardhit ekzistues prej

rreth 100 kilometrash. "Nuk jam i kënaqur me marrëveshjen. Nuk e bën punën e duhur, por unë do të gjej fonde të tjera. Ne kemi për të ndërtuar një mur të mrekullueshëm, të fortë, që nuk do t'i lejojë kriminelët, trafikantët e drogës dhe drogat të hyjnë në vendin tonë", tha presidenti Trump.

Kryetari i shumicës në Senat, Mitch McConnell, shprehu optimizëm për marrëveshjen. "Unë mendoj se kemi një marrëveshje të mirë. Kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, tha se nuk do të jepet asnjë dollar për murin. Ndoshta tani do të kemi një diskutim se si do të jetë muri apo gardhi. Demokratët kërkonin përmirësimin e qendrave të ndalimit. Mendoj se presidenti ia doli", tha ai.

Kryetari i pakicës në Senat, Chuck Schumer, i bëri thirrje presidentit ta nënshkruajë mar-

rëveshjen. "Presidenti nuk duhet të bëjë të njëjtin gabim që bëri dy muaj më parë, kur patëm një marrëveshje dypartiake dhe ai nuk e nënshkroi, që solli mbyllje e qeverisë", tha ai.

Presidenti Trump tha të martën se nuk do të ketë një tjetër mbyllje të qeverisë. "Nuk besoj të kemi një tjetër mbyllje të qeverisë. Nuk do ta bëja këtë. E patëm një mbyllje për fajin e demokratëve", tha presidenti. Por ai tha se do të shqyrtonte çdo mundësi për

ndërtimin e murit, përfshirë deklarinë e gjendjes së emergjencës kombëtare në kufi, për marrjen e fondeve të nevojshme. Deklarimi i situatës emergjente mund të ndeshet me sfida ligjore, që do ta vononin ndërtimin e murit. Por, presidenti ka privilegjin e ekzekutivit për të marrë disa nga fondet e emergjencës, nëse e sheh të nevojshme, tha senatori demokrat Joe Manchin, i Virxhinias Perëndimore. "Do të

shpresoj që ai të mos i marrë fondet nga fusha të nevojshme, si përmbytjet apo zjarret masive, apo çdo lloj katastrofe tjetër. Ka disa fusha të tjera që nuk janë aq të nevojshme dhe besoj se ai këtë mundësi është duke shqyrtuar", tha Manchin.

Detajet e marrëveshjes për sigurinë e kufirit mbeten për t'u bërë publike dhe ligji duhet miratuar nga të dyja dhomat e Kongresit para se t'i shkojë për firmë presidentit.

Pompeo në Evropën Qendrore, Kina dhe Rusia në qendër të vëmendjes



WASHINGTON, 13 SHKURT - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, ndodhet në një turne në vendet e Evropës Qendrore. Gjatë qëndrimeve në Sllovakia dhe Hungari, në qendër të diskutimeve ka qënë influenca në rritje e Rusisë dhe Kinës në rajon. Përveç tonit të ngrohtë në shkëmbimet mes shefit të diplomacisë amerikane dhe aleatëve të Evropës Qendrore në NATO, dukeshin qartë tensionet mbi tema si liria

e shtypit dhe marrëdhëniet me Rusinë.

Sekretari Pompeo tha se Shtetet e Bashkuara kanë qënë mik i Sllovakisë gjatë tre dekadave të pavarësisë së saj, duke shtuar se përkrahja amerikane do të vazhdojë. Shefi i diplomacisë amerikane u shpreh me tone miqësore edhe në takimin me homologun hungarez, duke folur me keqardhje për tërheqjen e Amerikës nga Evropa Qendrore që i kishte dhënë mundësi

Rusisë dhe Kinës ta mbushnin vakuumin. "Fola me ministrin e Jashtëm mbi nevojën urgjente për ta mbështetur Ukrainën në përpjekjet e saj për sovranitet dhe integritet territorial. Nuk duhet t'ia lejojmë presidentit rus, Putin, të krijojë përcarje mes miqsh dhe aleatësh në NATO. Hungarezët e kanë mësuar mirë nga historia e tyre, se Rusia autoritare nuk do të jetë kurrë mike e lirisë dhe sovranitetit të kombeve", tha Pompeo.

Nuk miratohet buxheti, Spanja në prag të zgjedhjeve të parakohshme

MADRID, 13 SHKURT - Spanja pritet të shkojë në zgjedhje të parakohshme për herë të tretë brenda më pak se katër vjetësh për shkak se partitë e qendrës së djathtë dhe deputetët katalonas kanë votuar kundër miratimit të

buxhetit shtetëror. Kryeministri i Spanjës, Pedro Sanchez, është duke u përballur me një betejë të ashpër politike për buxhetin e vitit 2019 për shkak të kundërshtimit të fuqishëm nga opozita dhe kritikët

e Qeverisë. Partia e kryeministrit Sanchez i ka vetëm 84 ulëse në kuvendin me gjithsej 350 ulëse. Ajo kishte ardhur në pushtet pas votës së mosbesimit ndaj Partisë Popullore Konservatore, me ndihmën e

partive nacionaliste baske dhe katalonase, shkruan "The Guardian". Sidoqoftë, dy partitë kryesore katalonase i janë bashkuar Partisë Popullore dhe partisë "Qytetarët", të cilët votuan kundër miratimit të buxhetit



të propozuar nga qeveria. Kundër buxhetit ishin 191 deputetë, 158 deputetë e përkrahën atë dhe një deputet ka abstenuar.



ROYAL CROWN



**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



E rrallë

Zbulohet leopardi i zi për herë të parë pas 100 vjetësh

Leopardi mitik afrikan i zi ekziston me të vërtetë. Biologët kanë zbuluar macen e hijshme duke ecur në Kenia. "Është hera e parë që kafsha fotografohet në Afrikë që nga viti 1909", ka thënë Nick Piffold, një shkencëtar botëror. Piffold u shpreh se arritën ta realizonin fotografinë e



pabesueshme pas disa muajsh vëzhgim dhe pritje.

FOTO E DITES



Një njësi taktike e policisë nga Austria shihet duke bërë gara gjatë sfidës së UAE SWAT në Dubai. /AP/

E jashtëzakonshme

Habit analisti i njohur, nuk ka larë duart prej 10 vjetësh

Një prej analistëve dhe aksionarëve të "Fox News", Pete Hegseth, ka pranuar në transmetim të drejtpërdrejtë se ai nuk i ka larë duart prej 10 vjetësh duke thënë se "mikrobet nuk janë të vërteta". Duke folur



për "Fox dhe Friends", Hegseth ka pohuar se mikroorganizmat infektive nuk ekzistojnë sepse nuk mund të shiheshin me sy të lirë.

BARSOLETA E DITËS



I thotë biondja shoqes së vet bionde:
- Paramendo, dje u ndal rryma, mbeta në ashensor rrafsh një orë.
- Po kjo nuk është asgjë. Unë kam mbetur tri orë në shkallët lëvizëse.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Besimi i madh që keni tek miqtë tuaj vjen si pasojë e sigurisë që ju kanë dhënë në momente të vështira. Pa ta ndjeheni i humbur.



DEMI

Kujdes me emocionet sot. Shumë herë shkoni në drejtim të gabuar vetëm sepse ndikoheni nga emocionet e momentit.



BINJAKËT

Familja juaj nuk është se e pranon shumë lidhjen e re sentimentale që sapo keni nisur. Një debat i papritur sot midis partnerit dhe njerëzve të afërt.



GAFORRJA

Për më të vegjlit e shenjës shkolla apo kopshti do të sjellë angazhime të reja. Të gjithë do të jenë të preokupuar me këtë event sot.



LUANI

Nëse keni planifikuar një udhëtim pune, mund të jini të qetë. Gjithçka do të shkojë mjaft mirë dhe ju do të ktheheni me lajme pozitive.



VI RGJËR ESHA

Gjërat në përgjithësi janë në harmoni të plotë sot për ju. Përveç ndonjë problemi të vogël në çift që do të zgjidhet shpejt.



PESHORJA

Do të shuani çdo mosmarrëveshje sot si në punë edhe në familje. Në fund të ditës do të kuptoni që keni vepruar drejt.



AKREPI

Sot do të keni disa probleme sa i përket financave. Do të dalin shpenzime të pa llogaritura më parë që do t'ju prishin disi rendin e ditës.



SHIGJETARI

Do t'ju përfshijnë në projekte që nuk janë ide e juaja në punë. Kjo gjë nuk është se ju pëlqen megjithatë do të jepni më të mirën.



BRICJAPI

Këtë periudhë keni pasur probleme me gjumin. Bëni mirë të kujdeseni më shumë për veten dhe të anashkaloni pjesën tjetër të ngarkesës.



UJORI

Sot ndjeheni shumë nostalgjikë mbase nga koha mbase sepse kujtimet nuk ju lënë të qetë. Ka gjëra që është mirë të mos i rikujtoni shpesh.



PESHQIT

Fillimi i kësaj ditë është i dedikuar i gjithi punës. Jeni shumë të zënë me projekte që duhet t'i realizoni sa me shpejt.

Nick dhe Priyanka po bëhen prindër?



Nick Jonas dhe Priyanka Chopra po e zgjerojnë familjen? Ajo foli pikërisht në lidhje me këtë në një intervistë të fundit. "Të dy e dimë se kjo është diçka që duhet të ndodhë, por nuk është diçka për të cilën mendoj shumë", ka thënë aktorja

36-vjeçare për "People". "Të dy e duam punën, jemi të martuar dhe e mbështesim shumë njëri-tjetrin. Kështu që jam e sigurt se do të ndodhë së shpejti. Ne patjetër që duam fëmijë dhe, kur është koha e duhur, do të ndodhë", ka thënë ajo.

Liam Hemsworth shtrohet në spital



Adam Devine ka bërë një përditësim në lidhje me Liam Hemsworth i cili është duke u trajtuar në një spital për shkak të gurëve në veshka. "Kam shkruar me të pak. Unë e di që ka pasur shumë

dhimbje dhe kjo po e bën atë të ndihet keq", ka thënë ai për "Us Weekly". Adam dhe Liam janë bashkëpunëtorë në filmin "Isn't It Romantic" i cili e pati premierën këto ditë.



Paris Hiltoni bëhet pjesë e Javës së Modës në Nju Jork

Biznesmenja Paris Hilton ka qenë pjesëmarrëse e Javës së Modës në Nju Jork. Ajo sfidoi në pistën e "The Blons Show". Hilton pati të veshur një fustan

ngjyrë metali dhe një aksesor ko shkruhej "Blonds". Parisi është beqare që nga nëntori i vitit 2018, pasi u nda nga ish i fejuari, Chris Zylka.

Policia arreston reperin e njohur



Policia thotë se reperin e njohur si Young Bou Never Broke Again është arrestuar në një hotel në Atlanta nën akuzën për sjellje të çrregullt. Mediat raportojnë se artisti,

emri i të cilit është Kentrell Gaulde, u vu në pranga të hënën pasdite së bashku me Starr Thigpen në shtëpinë e Hyatt. Të dy u akuzuan edhe për posedim të marjuanës.

Dyli me videoklipin 'Një moment' falënderon ata që bënë mrekullinë për të



coming soon...
directed by Blerdi Malushi

- Mrekullia vjen nga Zoti dhe nga doktorët shqiptarë

PRISHTINË, 13 SHKURT - Këngëtari i ri, Abdyl Morina, i cili pas lindjes nga familja është pagëzuar me emrin e gjyshit, Abdyl, qysh në moshën katërvjeçare ka filluar të këndojë me pasion të veçantë. Dyli, siç e quajnë tash, është rritur me plot vullnet dhe lumturi me vëllezër dhe motra, shokë e shoqe. Por, Dyli, për dallim nga bashkëmoshatarët e tij, është balafaquar edhe me një sfidë të madhe sa i përket gjendjes shëndetësore por që, falë vullnetit të tij, kujdesit familjar dhe punës dhe përkushtimit të pashoq të shefit të Qendrës

Spitalore të Neurokirurgjisë në Tiranë, prof. dr. Mentor Petrela, dhe doktorit Alfred Aga, tash Dyli i është kthyer jetës normale dhe pasionit të vet, këngës. Ai ka plot projekte para vetes me të cilët dëshiron t'i bëjë të lumtur, pos bashkëmoshatarët, edhe prindërit që në asnjë çast nuk hoqën dora nga ai.

Gjithashtu, Dyli u përcjell mesazh të gjithëve atyre të cilët gjatë udhëtimit të tyre jetësore, qoftë si këngëtar, si nxënës, si punëtor, si bujq etj., të kenë besim në vetvete sepse, nëse sfidohesh nga ndonjë sëmundje, atë duhet ta

përballosh.

Dyli përçon mesazh për opinionin se duhet të ketë besim edhe në mjekët tanë shqiptarë, andej e këndej kufirit (Kosovë - Shqipëri) pasi, falë tyre, mund t'ia dalësh dhe ta vazhdosh jetën aty ku e ke lënë dhe të ecësh përpara me projektet që të presin.

Dyli gjithë këtë sfidë që ka pasur si një i ri ka vendosur ta përshkruajë për disa minuta me një këngë të cilën e ka titulluar "Një moment". Kjo këngë ka një videoklip të jashtëzakonshëm, ku Dyli përmes vargjeve të këngës falënderon mjekët, Klinikën Universitare të Neurologjisë së Tiranës që kishin besim në shërimin e tij. Dyli të gjithë historinë e shërimit të vet e paraqet në këtë videoklip, i cili është shenjë falënderimi për Mentor Petrelën dhe Alfred Agën.



Poezia "Lamtumirë", lirikë e atdhetarisë së Gonxhe Bojaxhiut, Nënës Terezë

ISAK ESHREFI

Gonxhe Bojaxhiu, Nëna Tereza, altruistja e famshme me origjinë shqiptare, me rastin e udhëtimit të saj për në Indi, më 9 dhjetor të vitit 1928, shkroi lirikën e njohur titulluar "Lamtumirë". Poezia përkatëse ngërthen nëntë strofa, katër vargësh, me rimë të kryqëzuar. Dashuria dhe përmallimi, përgjërimit dhe nostalgjia e Nënës Terezë për vendlindje e farefis është tejet spikatëse që në vargjet e strofës së parë të kësaj lirike:

*"Po lë shtëpinë zemër fanar,
Vendlindje e farefis,
Po shkoj n'Bengalin dergje-vrarë,
Atje në të largët in fis".*

Të afërmit e të njohurit, duke i lënë në mëtime, Nëna Terezë klith me shpirt të përmalluar, gërshetuar me ndjenja dhembshurie, përplot nostalgji:

*"Nënë e dashur, lamtumirë,
Ju lë shëndet miq të mi,
Më djeg, o një fuqi e dliirë,
Drejt të përflakurës Indi".*

Çdo fjalë e çdo varg e kësaj lirike spikatëse është ngjyrosur me mall dhe dashuri, me përgjërimit dhe me përmallim të shpirtit të flijetorës së zvarritur për komb e atdhe, "Nuse e njomë e botës së re".

*"Dhe anija lehtë- lehtë lundron,
Pret valët e detit të trazuar
Për herë të fundit syri vrojton
Brigjet e Evropës së hakërruar".*



Japonia fajëson telefonat për dëmtimin e shikimit tek nxënësit

Sipas Ministrisë Japoneze të Arsimit, Kulturës, Sportit, Shkencës dhe Teknologjisë, duket se vendi ka një problem me shëndetin e studentëve. Për të qenë më specifik, duket se ata kanë gjetur një rekord të lartë të nxënësve (prej 25.3%) që nuk kanë arritur të përmbushin shenjën 1.0 në testet e shikimit dhe se ndoshta koha e gjatë e shpenzuar në telefona dhe lojërat mobile mund të jetë përgjegjës për këtë.

Duket se 34.1% e nxënësve fillorë dhe 67.09% të nxënësve të



shkollave të mesme nuk kanë vizion 1.0 (i njohur gjithashtu si vizioni 20/20).

Ministria shkruan: "Sipas ekspertëve, kjo mund të lidhet me rritjen e kohës së kaluar duke shikuar ekranet e telefonave dhe lojërat mobile".

Në anën tjetër, disa kanë shprehur dyshimet e tyre për atë nëse lojërat dhe telefonat janë shkaktari i vërtetë për t'u fajësuar për këtë. Në të njëjtën kohë, lojërat e telefonave në Japoni janë një industri e madhe pasi Japonia është në të

vërtetë tregu i tretë më i madh i lojrave në botë, prandaj nuk është për t'u habitur që ka shumë të rinjë që shpenzojnë shumë kohë në lojra.

Ndërkohë ekzistojnë disa kompani të telefonave të cilët po prezantojnë mënyra për përdoruesit e tyre për të menaxhuar kohën e tyre në telefona, si dhe prezantimin e disa veçorive shëndetësore që ndihmojnë në zvogëlimin e sasisë së dritës blu që vjen nga pajisjet tona, që është i njohur edhe si ndërhyrës i gjumit.

Ja se si ndikon telefoni në trurin e fëmijut tuaj

Telefonët po ndryshojnë mënyrën se si punon truri i fëmijëve, sipas hulumtimeve të reja. Të rinjtë që kalojnë më shumë se dy orë para një ekrani tregohen më të dobët në testet e gjuhës dhe të menduarit. Në mënyrë alarmuese, fëmijët që shpenzojnë më shumë se shtatë orë në ditë në pajisjet elektrike po shfaqin gjithashtu hollësimin e parakohshëm të korteksit të trurit, që zakonisht ndodhë më vonë në zhvillim.

Studimet e mëparshme kanë lidhur korteksin më të hollë me nivele të ulëta të IQ. Rezultatet janë të parat nga një studim ambicioz prej \$ 300,000,000 që do të gjurmojë zhvillimin e trurit të 11,000 fëmijëve gjatë një dekade.

Ekspertët thonë se ne nuk do të dimë efektet e vërteta të telefonave dhe teknologjive të tjera në zhvillimin e trurit, derisa

grupi të arrijë moshën e rritur. Sidoqoftë, gjetjet e tyre fillestare janë shqetësuese për cilindo prind, fëmija i të cilit përdor telefonin një kohë më të gjatë.

Fëmijët e moshës nëntë e dhjetë vjeç, të cilët kaluan më shumë se shtatë orë në ditë në mediat dixhitale, kishin modele dukshëm më të ndryshme nga bashkëmoshatarët e tyre, të cilët kaluan më pak kohë duke shikuar pajisjet.

Dr Gaya Dowling, nga Institutet Kombëtare të Shëndetit, tha: "Nuk e dimë nëse po shkaktohet nga koha e shpenzuar në ekran. Nuk e dimë ende nëse është gjë e keqe."

"Ajo që mund të themi është se kjo është si duket truri tek fëmijët që shpenzojnë shumë kohë në ekran. Dhe kjo nuk është model i vetëm."

Rezultatet e mëparshme nga



studimi i njëjtë treguan se fëmijët që kaluan më shumë se dy orë në ditë në ekranet

arritën rezultate më të ulëta në logjikim dhe teste gjuhësore. Fëmija mesatar amerikan dhe

britanik shpenzon rreth katër orë në ditë i zhytur në mediat dixhitale.

Gjenden "prova të qarta" të lidhjes së rrezatimit të telefonave me kancerin tek brejtësit



Duke qenë se telefonat tanë (dhe shumë pajisje tona elektronike) japin rrezatim, ka shumë njerëz që pyesin nëse telefonat tanë lëshojnë rrezatim të mjaftueshëm që të mund të jenë potencialisht të rrezikshëm për shëndetin tonë. Tani, sipas një studimi të ri nga Programi Kombëtar i Toksikologjisë në SHBA, duket se ka "prova të qarta" të rreziqeve shëndetësore. Sidoqoftë, para se të shqetësoheni, duhet të theksohet se kjo "dëshmi e qartë" e rreziqeve shëndetësore është vërtetuar në minjtë, jo në njerëz. Hulumtuesit në të vërtetë pub-

likuan një draft të raportit të tyre në fillim të këtij viti ku ata thanë se gjetën "disa prova", por pas shqyrtimit të kolegëve, ajo u ndryshua në "dëshmi të qarta" në nivele të larta të radiofrekuencave të përdorura në telefonat celularë dhe zhvillimin e tumoreve tek minjtë.

Sipas John Bucher, një shkencëtar i lartë në programin e toksikologjisë, "Ndryshimi nga disa prova në prova të qarta reflekton besimin e rritur që kanceri i vëzhguar në minjtë meshkuj u shoqërua me ekspozimin ndaj rrezatimit të radio frekuencave. NTP e konsideron kategorinë

një gjetje pozitive të kancerit." Megjithatë jo të gjithë duket se pajtohen me këto gjetje. Jeffrey Shuren, drejtor i Qendrës së Pajisjeve dhe Shëndetit Radiologjik të FDA, tha: "Ne nuk pajtohemi me konkluzionet e raportit të tyre përfundimtar lidhur me dëshmitë e qarta të veprimtarisë kancerogjene në brejtës".

"Studimi nuk u hartua të testojë sigurinë e përdorimit të telefonit të mençur në njerëz, kështu që nuk mund të nxjerrim konkluzione rreth rreziqeve të përdorimit të telefonit nga ai." shtoi Shuren.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	BATE BORISOV - ARSENAL	2	RAPID VJENA - INTER	2	MALMOE - CHELSEA	2-2
-------------------	------------------------	---	---------------------	---	------------------	-----

Flet për "Epokën e re" kryetari i Federatës së Taekwondos së Kosovës, Gani Krasniqi

Krasniqi: Kosova ka shumë talente në taekwondo

Numri një i sportit të taekwondos në Kosovë, Gani Krasniqi, është zotuar se do të angazhohet maksimalisht për masivizimin e këtij sporti. Ai në këtë intervistë për gazetën "Epoka e re" ka deklaruar se Kosova ka shumë talent të taekwondos

EPOKA E RE **Liridon ZEQRIRI**

PRISHTINË, 13 SHKURT - Kryetari i Federatës së Taekwondos së Kosovës, Gani Krasniqi, ka bërë me dije se Kosova ka shumë talent për këtë sport. Ai ka deklaruar se brenda një kohe shumë të shkurtër Kosova do të nxjerrë shumë Majlinda Kelmendi në sportin olimpik të taekwondos. Krasniqi në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re" është zotuar se do të angazhohet maksimalisht për masivizimin e këtij sporti në Kosovë. "Talent në taekwondo ka shumë, ashtu sikurse ka në xhudo por, fatkeqësisht, ky sport është lënë anash për shumë vjet dhe është drejtuar nga persona që kanë punuar vetëm për interesa personale. Unë besoj se për një kohë shumë të shkurtër do të kemi edhe shumë Majlinda Kelmendi në sportin olimpik të taekwondos", ka thënë Krasniqi. Ai ka folur edhe për objektivat që do t'i realizojë gjatë mandatit në krye të kësaj federate. "Prioriteti im kryesor gjatë këtij mandati është që ta ruajmë bashkimin e të gjitha klubeve aktive, të punojmë shumë për të bërë sa më shumë klube që sporti i taekwondos të masivizohet në çdo qytet të Kosovës. Dëshira ime është që sportistët tanë të bëhen të respektuar dhe të disiplinuar në punë dhe rezultatet e tyre nuk do të mungojnë që të fitojnë medalje evropiane, botërore dhe olimpike", është shprehur ai.

"Epoka e re: Z. Krasniqi, tani jeni zgjedhur në krye të Federatës së Taekwondos. Si e keni gjetur këtë federatë?"

Krasniqi: Unë jam zgjedhur kryetar i



Federatës. Me këtë sport jam marrë me më shumë se 25 vjet. Për ata që nuk e dinë, ky sport vjen nga Koreja dhe kuptimi i tij është: tae-këmbë, kwon-dorë, domendje. Pra, është sport me kombinim të këmbëve, duarve dhe të mendjes. Ky sport është më i vjetër se 1 500 vjet. Federatën e kam gjetur të ndarë në dy federata, pa asnjë aktivitet dhe pa shpresë për t'u zhvilluar. Me dëshirën që ky sport të zhvillohet, përgjatë tre vjetëve të fundit kam biseduar me dy federatat me qëllim që të bashkohemi dhe këtë sport ta zhvillojmë. Deri më tani interesi për këtë sport ka qenë krejt tjetër. Pas këtyre bisedimeve të gjithë jemi bërë bashkë dhe se tani në Kosovë kemi një federatë dhe kemi qëllime të qarta.

"Epoka e re": Më 23 shkurt 2019 do të mbahet kampionati i Kosovës në Taekwondo. Çfarë prisni nga ky kampionat?"

Krasniqi: Nga kampionati i Kosovës në taekwondo, i cili do të mbahet në shkurt të këtij viti, presim sukses të madh, pasi për herë të parë do të marrin pjesë të gjitha klubet aktive që janë në Kosovë. Fituesit ose kampionët që do të fitojnë në këtë kampionat do ta përfaqësojnë Kosovën në garat ndërkombëtare, si ato evropiane, botërore dhe olimpike. Uroj që në këtë garë të fitojnë sportistët më të mirë.

"Epoka e re": A ka Kosova talent në taekwondo sikurse në xhudo?"

Krasniqi: Talent në taekwondo ka shumë, ashtu sikurse ka në xhudo por, fatkeqësisht, ky sport është lënë anash për shumë vite dhe është drejtuar nga persona që kanë punuar vetëm për interesa personale. Besoj se për një kohë shumë të shkurtër do të kemi edhe shumë Majlinda Kelmendi në sportin olimpik të taekwondos.

"Epoka e re": Cilat janë synimet tuaja gjatë këtij mandati në krye të Federatës?"

Krasniqi: Prioriteti im kryesor gjatë këtij mandati është që ta ruajmë bashkimin e të gjitha klubeve aktive, të punojmë shumë për të bërë sa më shumë klube që sporti i taekwondos të masivizohet në çdo qytet të Kosovës. Dëshira ime është që sportistët tanë të bëhen të respektuar dhe të disiplinuar në punë dhe rezultatet e tyre nuk do të mungojnë që të fitojnë medalje evropiane, botërore dhe olimpike.



SHKURT

Në gjysmëfinale Vëllaznimi - Trepça '89 dhe Ballkani - Feronikeli

Sot në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), në praninë e përfaqësuesve të klubeve, është bërë tërheqja e shortit për gjysmëfinale të Digitalb Kupës së Kosovës. Në gjysmëfinale do të takohen Vëllaznimi - Trepça '89 dhe Ballkani - Feronikeli. Ndeshjet e para do të zhvillohen më 17 prill, kurse ndeshjet e kthimit do të luhen më 1 maj.

Rashica kërkohet nga Crystal Palace

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Milot Rashica, po shkelqen në fanellën e Werder Bremenit në Bundesliga. Ish-lojtari i Vushtrisë ka shënuar dy gola për Bremenin në fundjavë, kurse "CalcioMercato" raporton se interesim për shërbimet e tij ka shfaqur skuadra angleze, Crystal Palace. 22-vjeçari ka bërë karrierë të suksesshme edhe në Holandë, ku për tre vjet për Vitessen regjistroi 83 paraqitje dhe shënoi 13 gola.

HC Berchem transferon Arbër Qerimin

Hendbollisti i njohur Arbër Qerimi ka kaluar te skuadra e njohur nga Luksemburgu, HC Berchem. Qerimi është 28-vjeçar dhe luan në rolin e qendrës. Ai luan rregullisht për Belgjikën dhe është prej më të mirëve në këtë kombëtare. Qerimi në pjesën e dytë të vitit të kaluar luajti me Zagrebin, skuadrën e njohur kroate me të cilën u paraqit edhe në Ligën e Kampionëve. Me Zagrebin është ndarë në fund të dhjetorit dhe tani e vazhdon karrierën në Luksemburg. Qerimi ka bërë karrierë edhe në Francë te Reennesi dhe te skuadrat belge Tongeren, Sportin NeLo e Union Beynoise.

Kololli: Napoli, kundërshtar i vështirë

Futbollisti i Kosovës, Benjamin Kololli, është i gatshëm për sfidën e ardhshme që skuadra e tij, Zurichu, e zhvillon ndaj Napolit në Ligën e Evropës. Ai e ka vlerësuar skuadrën italiane si një kundërshtar të vështirë. "Një skuadër e fortë, mbi të gjitha në aspektin kualitativ. Ka shumë lojtarë të shpejtë dhe teknikisht të fortë si Insigne e Callejon. Në mbrojtje, po ashtu, Koulibaly është mjaft i mirë. Pa dyshim, ishte një prej rivalëve më të vështirë që ka mundur të na binte, por do ta bëjmë të pamundurën për ta vënë në vështirësi", ka thënë Kololli për "Calciomercato.it".

Zidane, objektiv i Chelseat për pasardhës të Sarrit

LONDËR, 13 SHKURT - Zinedine Zidane është objektiv kryesor i drejtuesve të Chelseat për zëvendësimin e Maurizio Sarrit, nën drejtimin e të cilit blutë e Londrës po kalojnë një periudhë krize rezultatesh, që kulmoi

me humbjen 6-0 ndaj Manchester Cityt. Mësohet se londinezët janë gati të formulojnë një ofertë për francezin, që ka marrë një vit pushim pas aventurës tepër të suksesshme në krye të Realit të Madridit, ku

fitoi tri Liga të Kampionëve radhazi dhe titullin e La Ligës. Ideja e Roman Abramovichit është ta marrë francezin, për ta bindur mesfushorin belg, Eden Hazard, që ta rinovojë kontratën dhe ta injorojë interesimin e

vazhdueshëm dhe serioz të Realit të Madridit. Sarri, gjithsesi, ka ende kohë për ta ndryshuar rrjedhën e ngjarjeve, por ka një kalendar vërtet të çmendur dhe të vështirë për ta kthyer besimin e drejtuesve.



Lazio - Sevilla, kryendeshja në Ligën e Evropës



luajë si mysafir i skuadrës së Bate Borisovit, kurse edhe Interi është mysafir i Rapid Vjenës. Si mysafir do të luajnë edhe Napoli dhe Chelsea ndaj Zurichut dhe Malmos. Ndeshjet e para fillojnë në orën 18:55, kurse ndeshjet e dyta nga ora 21:00.

ÇIFTET E EVROPA LIGËS

18:55 BATE Borisov - Arsenal
18:55 FC Krasnodar - Bayer Leverkusen
18:55 Galatasaray - Benfica
18:55 Lazio - Sevilla
18:55 Olympiacos - Dynamo Kyiv
18:55 Rapid Wien - Inter
18:55 Rennes - Real Betis
18:55 Slavia Prague - Genk
21:00 Celtic - Valencia
21:00 Club Brugge - Salzburg
21:00 FC Zuerich - Napoli
21:00 Malmoe FF - Chelsea
21:00 Shakhtar Donetsk - Eintracht Frankfurt
21:00 Sporting CP - Villarreal
21:00 Viktoria Plzen - Dinamo Zagreb

ROMË, 13 SHKURT - Pas ndeshjeve në Ligën e Kampionëve, sonte (e enjte) është koha për ndeshjet në Ligën e Evropës. Kryendeshja e 1/16 e finales do të zhvillohet në kryeqytetin e Italisë, Romë. Lazio e shqiptarëve do ta presë skuadrën e Sevillas.

Skuadra italiane do të mundohet ta marrë maksimumin nga kjo ndeshje për faktin që në ndeshjen e dytë të ketë punë më të lehtë në Spanjë, por Sevilla është "eksperte" në Ligën e Evropës dhe eliminimi i saj do të jetë i vështirë. Arsenal do të

Golden State shkëputet në Perëndim, Lakersi zhgënjën sërish



OAKLAND, 13 SHKURT - Golden State korri suksesin e 41-të sezonal pas fitores 115-108 ndaj Utah Jazzit, sfidë me rivalitet dhe emocione në shumicën e kohës. Të dyja ekipet duelian fort, por diferencën e bëri treshja Durant (28), Curry (24) e Thompson (22), që së bashku realizuan 74 pikë. Për Jazzin u dallua Mitchell me 25 pikë, por që mbetën për statistikë. Vijon të zhgënjë skuadra e Lakersit, që u mund 117-113 nga Atlanta jashtë fushës, sfidë ku herë udhëhiqte njëri ekip e herë tjetri. Collins e Youngu realizuan nga 22 pikë për Atlantën, ndërsa LeBron Jamesi realizoi një "triple

double" për kalifornianët (28 pikë, 11 rebounde e 16 asistime), por që mbetën për statistikë. Në sekondat e fundit fiton San Antonio, që mundi 108-107 Memphisin, takim ku Millsi e Aldridge realizuan nga 22 pikë për skuadrën e Spursit. Memphis pati shansin të barazojë apo fitojë, por gaboi në fund, ndërkohë që Bradley realizoi 33 pikë, por që nuk mjaftuan për ta evituar humbjen. Fitoi edhe skuadra e Bostonit, që mposhti 112-109 Philadelphia, një përballje mes dy ekipesh pretendente për titullin në Lindje. Edhe pse mungoi Irvingu,

skuadra e Celticsit bëri një lojë të mirë, me Haywardin që realizoi 26 pikë, duke i bërë të pavlefshme 23 pikët e 14 reboundet e Embiidit për vendësit. Orlando mundi me lehtësi 118-88 New Orleansin, ndeshje ku katër lojtarë të ekipit mik realizuan mbi 20 pikë (Vuçeviq 25).

REZULTATET

Atlanta - Lakers 117-113
Memphis - San Antonio 107-108
New Orleans - Orlando 88-118
Philadelphia - Boston 109-112
Golden State - Utah Jazz 115-108

SHKURT

Interi ia heq Icardit shiritin e kapitenit

Sulmuesi Mauro Icardi nuk do të jetë më kapiteni i skuadrës së Interit. Klubi italian e ka marrë vendimin të cilitin e ka bërë publik në "Twitter", por nuk ka dhënë arsye shtesë për heqjen e shiritit nga Icardi. Tash e tutje kapiteni i skuadrës së Interit do të jetë Samir Handanović, i cili ishte zëvendëskapiten. Pas këtyre zhvillimeve e ardhmja e argentinasi pritet të jetë larg Interit, kurse interesim për të kanë shfaqur Juventusit dhe Real Madridi. 25-vjeçari është pjesë e Interit që nga viti 2013, kurse ka regjistruar 177 paraqitje dhe ka shënuar 109 gola.

Juve "çmendet" për Salahun

Skuadra kampione e Italisë, Juventus, është gati ta bëjë "çmendurinë" për ta transferuar yllin e Liverpoolit, Mohamed Salah. "Tuttosport" raporton se drejtuesit e "Zonjës së Vjetër" janë të gatshëm të ofrojnë 50 milionë euro dhe sulmuesin Paulo Dybala për ta bindur klubin anglez për ta liruar futbollin egjiptian. Salahu ka luajtur për Chelsea, kurse në Itali ishte pjesë e Fiorentinës dhe Romës.

Solskjari: Nuk kemi luajtur në këtë nivel që një kohë të gjatë

Trajneri i Manchester Unitedit, Ole Gunnar Solskjær, pas humbjes nga PSG-ja, ka thënë se ishte e dukshme që ekipi i tij nuk ka luajtur në këtë nivel që një kohë, prandaj duhet të mësojë nga këto situata. "Djajtë e kuq" pësuan humbje në shtëpi nga PSG-ja me rezultat prej 0-2. "PSG-ja kishte momentumin pas shënimit të golit të parë dhe kontrolloi lojën. Mund ta shihnit se ne nuk kemi luajtur në këtë nivel që një kohë dhe duhet të mësojmë. Është një përvojë që mund të shkojë në të dyja anët, nuk është definues i sezonit. Është një prej atyre rasteve prej të cilëve duhet të mësohet", ka thënë Solskjær.

Alonso mund të rikthehet në Formua 1

Fernando Alonso ka lënë të kuptohet gjatë fundjavës se mund të bëjë një rikthim me McLarenin. Spanjoli e kishte përfunduar karrierën si garues në Formula 1 pasi kaloi edhe një sezon tjetër zhgënjës me McLarenin. Dhe tani po ndjek synimin për të kaluar në "Triple Crown Motorsport", ku në Indianapolis 500 po kërkon lavdinë e dikurshme. Futja e Alonso mund të ketë një ndikim të madh në mënyrën se si McLaren ka ndërtuar makinën e tyre 2019 për Carlos Sainz dhe Lando Norris. "Nuk e dimë ende, do të shohim", ka thënë drejtori sportiv Gil de Ferran për gazetën spanjolle "AS", kur u pyet nëse Alonso është i vendosur që ta ndihmojë ekipin. Alonso la të kuptohet javën e kaluar se mund të kthehej në F1 në vitin 2020, duke thënë se: "Unë thashë se duhet t'ia lëmë kohës dhe jo lamtumirë. Nuk kam plane për vitin 2020. Natyrisht, fitimi i një titulli të tretë do të ishte gëzimi më i madh".

Arbeloa: Messi nuk më ka pëlqyer kurrë, uroj ta lërë futbollin para kohe

Ish-lojtari i Real Madridit, Alvaro Arbeloa, është një nga ata që nuk e shijon lojën e Lionel Messit. Diçka të tillë e ka thënë hapur në emisionin "El Chiringuito", ku tanimë do të bëjë komentatorin. Por nuk është ndalur vetëm me kaq, pasi ka deklaruar se dëshiron që argentinasi të tërhiqet sa më shpejt nga futbollit i luajtur. "E respektoj shumë Barcelonën. Është ekip i madh dhe me një lojtar të shkëlqyer si Lionel Messi. Ai është shumë i mirë, por unë nuk kam qenë në gjendje të zbavitim duke e parë atë dhe mendoj se nuk do të jem në gjendje kurrë. Shpresoj të tërhiqet nga futbollit para kohe. Unë po numëroj ditët", ka thënë Arbeloa, duke shtuar: "Unë nuk jam kundër Barcelonës. Gjithmonë dëshiroj që ajo të humbasë, pasi është gjë e mirë për Realin e Madridit. A do të doja të dështonte në Ligën e Kampionëve? Po, do të kishte një rival më pak për Realin. Barcelona ka qenë gjithmonë një ekip sfidues. Është ekip i shkëlqyer. Gjithmonë doja ta mundja".

	Autor: GAZMEND MORINA	KËNGËTARJA ANGLEZE COLE (shqip.)	NJËRA NDËR TRI GJINËTË KRYESORE TË KRIJIMTARISË LETRARE	VLERË, DOBI	PËREMËR VETOR	POLITIKANI SHQIPTAR NDOKA	EPOKA E RE	BASHKËTËNGËLLORE	GJENDJE E RËNDË E NJERIUT NË ÇASTET E FUNDIT TË JETËS	RAMADAN AVDIU	MALLKIMI DHE PËRJASHTIMI NGA KISHA DHE FEJA	MODELJA AMERIKANE TAYLOR
	VEGËL DORE, QË PËRBËHET NGA NJË KOKË METALI						KALLI MISRI QË RUHET PËR FARË, MISËR FARËS DY BASHKËTINGËLLORE					
	MBISHKRIM NË NJË GUR VARRI							EMËR YNI MASHKULLI KËNGËTARJA LIBOHOVA				
	MJET TRANSPORTI PA MOTOR, QË TËRHIQET NGA NJË AUTOMJET									ALFRED KEÇINARI		
	SHKOVE, ECE (bised.)					BASHKËT. DËMTIM I NJË MAKINE GJATË KOHËS SË PUNËS		DY BASHKËTINGËLLORE PËRKULJE NË NJËRËN ANË		TITAN SPIKERJA MUREZI - SHALA		
	LLOJ SËPATE						EMËR FEMRE MYSLIMANE KËNGËTARI POTOKU					I KËTËJ ÇASTI, I KËSAJ KOHE
EPOKA E RE		OHAJO, LUIZIANA	PJË ALKOOLIKE, QË NXIRRET NGA LËNGU I RRUSHIT	DAMARI I GJAKUT ANËTAR I NJË URDHRI FETAR, QË RRI NË NJË MANASTIR					LLOJ VETURE FRANCEZE KALLI MISRI QË VARET NË TRARËT E SHTËPISË			
DOLLAPI, RAFTI								GURRË (sh.shq.)				
EPOKA E RE	DRUAJTJA; FRIKA	QË KA TË BËJË ME FSHATARËSINË	SOLISTJA BYTYQI	FUTBOLLISTI RUMUN ADRIAN	I EMËRUAR	DHËNIE E NJË ÇMIMI TË LARTË BASHKËT.		"VIENA" SHITRESE			ZANORE SHKRIMTARI SHKRELI	
MË VJEN GJUMË DUKE NDENJUR							KËNGËTARI AMERIKANAN BROWN (shqip.) VARIOLË	ENË E MADHE PËR TË ZIER UJË GRUP MUZIKANTËSH (shq.)				
BANOR I NJË SHTETI EVROPIAN						I KEQ, ZEMËRKEQ, TINËZAR; I ... KORNIZA		AKTORI KUSHTRIM	ISH FUTBOLLISTI ITALIAN FRANKO (MILAN) "TORINO"			
ARTI I TË FOLURIT BUKUR								TRUPI I NJERIUT NGA KOKA DERI TE KËMBËT (pashq.) LION UILSON		BANOR I NJË QYTETI NË KOSOVË	EDI SHUKRIU FUTBOLLISTI ARGJENTINAS PABLO (BENFICA)	
JEMENI, ANGOLA			AKTORJA THURMAN MENDIM				PJESË E BRENDSHME E KËMISHËS (shq.)	KËNGËTARI AMERIKAN RUSSELL TANTAL, REOMIR		THIKË QË MBAHEJ SI ARMË BREZI E GDHENDUR		
LETRARI ASLLANI				I PESHUAR REGJISORI KRYEZIU (shq.)				EMËR MASHKULLI MYSLIMAN SHOK, JARAN			BASHKËT. I MBAROVA, I BITISA	
EPOKA E RE	DELTINË E BARDHË A E KUQE, ARGJILË (shq.)	ISH "MISS ALBANIA" KOLA AKTORJA AMERIKANE SOFER						SMALTIMI BOSHT				SHKENCA MBI MORALIN
BANORI I GREQISË						NDËRRIM I MALLIT (shq.) BASHKËT.			VENDËSE, RRËNJËSE			
LËRE (bised.)			KËNGËTARJA VALENTINA VIGANI, KOLOSI				KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS KËNGËTARI POSHKA		LLOJ LETRASH FATI PUSIA			
KLUB FUTBOLL I NË ITALI						MUNDËSI PËSËTAR I NJË FISI ILIR			BUNAR I UJIT GAZ PËR DEZINFEKTIMIN E UJIT (shq.)		SILIC PJESA E NGRITUR E TEATRIT KU LUJNË AKTORËT	
MUZIKANTI KRASNIQI				LLOJ AEROPLANI LUFTARAK AKTORI ... DAMON (shqip.)				VEZË PESHKU NGASËSI I "FORMULA 1" HAKINEN		SQUARE ARRAY KILOMETRE ANA VISI		
ARMENIA		AKTORI FLLOKO BUKURI, HJESH				ILVA MARE		AKTORI ÇELAJ "LOMEL"			ZANORE NOTË MUZIKORE	
EPOKA E RE	KAPËRDIJ DY BASHKËTINGËLLORE			ENI LENOKS ALYSSA MILANO		QYTET NË SHQIPËRI (pashq.) VRANËSIRË				HUQ, MANI "BOLIVIA"		"TETOVA"
XEHETAR							KËNGËTARI JETISHI BASHKËT.			DISIPLINË SPORTIVE RAVENA		
MAKIJAZH					TË FALA, PËRSHËNDËTJE (shq.)				GOJORE			

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"



**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333**

**American
Taste**

**SINCE
1905**



